



Kompania Rajonale e Ujësjetës
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

2018

Raporti i Zhvillimit të Aktiviteteve Afariste në K.R.U."Gjakova" Sh. A. Gjakovë

I. HYRJE

Në kuadër të këtij raporti do të përfshihen aktivitetet dhe ngjarjet më të rëndësishme të ndërmarrjes të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2018. Raporti është ndërtuar sipas kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të Aksionarit si dhe përmban edhe disa pjesë tjera të rëndësishme që e pasurojnë edhe më shumë këtë raport.

Në fillim të raportit është prezantuar fjala e kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, ku është theksuar performanca e kompanisë bashkë me disa prej aktiviteteve të saj. Raporti i Kryesuesit ofron informacione edhe në lidhje me kapitalin e kompanisë, politikat që ndikojnë në zhvillimin e biznesit si dhe të dhënat tjera për strukturën dhe angazhimet e Bordit.

Në vazhdim pasqyrohet raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, duke ofruar të dhëna për ngjarjet kryesore për periudhën raportuese, të dhënat për performancën operative e financiare dhe progresin në drejtim të realizimit të Planit të Biznesit. Në këtë pjesë raporti ofron të dhëna të detajuara për shpenzimet, investimet kapitale të kompanisë dhe gjithashtu një elaborim të perspektivës bashkë me rreziqet e mundshme ndikuese. Po ashtu brenda raportit është paraqitur edhe skema organizative e stafit të kompanisë, ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe si dhe një pjesë e raportit i është kushtuar çështjeve të ndryshme të lidhura me kontestet gjyqësore. Për të qenë raporti sa më i qartë dhe i kompletuar, brenda tij janë përfshirë edhe grafikone, tabela statistikore dhe skema tjera me sqarime të nevojshme.

Raporti Vjetor 2018 ka të bashkëngjitur edhe shtojcën apo Aneksin 1, i cili përmban të dhëna tjera shtesë të cilat mbasin për përdorim të Aksionarit. Në këtë pjesë janë përfshirë raporti lidhur me sponsorimet dhe donacionet, Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2017 dhe Raporti i Vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve.

FJALA HYRESE E KRYESHEFIT EKZEKUTIV



ISMET AHMETI
*Kryeshef Ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të
Ujësjiellësit "Gjakova" Sh.A. –Gjakovë*

Kam kënaqësinë dhe nderin të raportoje rezultate konkrete të K.R.U. " Gjakova" SH.A. e cila falë një strategjie të qartë dhe një ekzekutivi të përkushtuar, dinamik si dhe një personeli të vyer, këtë vit ka arritë stadin më të lartë të zhvillimeve pozitive në të gjithë treguesit e performancës së ndërmarrjes , duke arritur kështu që nga autoriteti ARRU-së të rangohet e para ndër të gjitha kompanitë e ujësjiellësit .Me këtë arritje Kompania është e vetë-qëndrueshme financiarisht, me shërbime kualitative për konsumatorët si dhe me një rritje të vëllimit të konsumatorëve . Pra, KRU"Gjakova "me sukses ka realizuar planin e biznesit edhe në aspektin e realizimit të projekteve ,duke arritë kështu të implementoj projektet e planifikuara , të cilat kanë pas impakt në rritjen e performancës teknike, zvogëlimin e humbjeve të ujit , zvogëlim të shpenzimeve operative, rritje/maksimizim të të ardhurave dhe furnizim më kualitativ për konsumatorët.

Menaxhmenti i Kompanisë gjatë vitit 2018 ,si dhe tërë stafi i Kompanisë janë munduar me përkushtimin e tyre maksimal ti arrijnë caqet e dëshiruara të biznesit dhe konsumatorit ti ofroj shërbimet më të mira .Nuk ka munguar bashkëpunimi me Konsumatorin, informimi i vazhdueshëm i tyre për shërbimet, shqyrtimi me kohë dhe në mënyrë efektive të kërkesave të tyre, intensifikimin i aktivitetit për zvogëlimin e humbjeve të ujit , rritjen e faturimit dhe arkëtimit, si dhe organizimit të punës dhe motivimit të mirë të stafit.

Ne e kemi mbyllur vitin fiskal në pasqyrat financiare me një rezultat pozitiv dhe të kënaqshëm operativ, duke ruajtur trendin pozitiv të ngritjes së realizimit të të hyrave të përgjithshme, veçanërisht tek të hyrat e konsumatorëve të mëdhenj,dhe të hyrat tjera operative.Gjithashtu Kompania ka qenë shumë aktive në revidimin dhe konsolidimin e kornizës ligjore e regullative .

Në drejtim të kryerjes së punëve operative teknike Ndërmarrja është munduar që të arrijë rezultatet e planifikuara. Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjiellësit dhe kanalizimit si dhe zvogëlimi i humbjeve të uji është arritur që të mirëmbahet sipas planit të paraparë. Suksesi është arritur përmes organizimit të punës ,formimit të grupeve të rregullta të kontrolles të cilët në kontinuitet kanë inspektuar rrjetin e ujësjiellësit dhe kanalizimit .Falë ndihmës së institucioneve vendore , donatoreve ndërkombëtar ,si dhe mjeteve tona vetanake me një profesionalizëm të lartë është arrit Implementimi i suksesshëm i të gjitha projekteve të planifikuara .

Vlen të cekët se me auditimin e bërë gjatë vitit 2018, opinionin e Auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare për vitin 2018, e prezanton qartë punën profesionale dhe përkushtimin e Ekzekutivit në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës. Kompania me mjete vetenake ka arrit të kryej me kohë obligimet e klientëve dhe institucioneve të Shtetit të Kosovës.

Për fund posaçërisht falënderojë Bordin e Drejtorëve të K.R.U. "Gjakova" SH.A. Gjakovë për përkrahje të vazhdueshme dhe inkurajuese për projektet dhe përkrahjen e Menaxhmentit të K.R.U. "Gjakova" SH.A. Gjakovë. Falënderojmë NJPMNP dhe partnerët tanë afaristë, që pa bashkëpunimin reciprok nuk do të kishim mundur të përmbyllim këtë vit suksesesh.

Mbi të gjitha më lejoni të shpreh mirënjohje dhe respekt për madhërinë e tij - Konsumatorin tonë besnik, i cili na beson dhe i pëlqen produkti i jonë, ujë me cilësi, sasi dhe shtypje të mjaftueshme, me furnizim 24 orësh, e që shpresojmë të kenë begatuar dhe lehtësuar shumë nevojat e përditshme dhe jetën e tyre në përgjithësi.

FJALA HYRESE E KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE



FATOS KOSHI
Kryesues i Bordit të Drejtorëve të Kompanisë Regjionale të Ujësjetës "Gjakova" Sh.A. –Gjakovë

Viti 2018 për Ndërmarrjen Publike Regjionale "Gjakova" Sh.A. ka qenë një vit i angazhimeve ,sfidave dhe i sukseseve në të gjitha aspektet e performances së ndërmarrjes .Për gjatë kësaj periudhe ne si Bord i Drejtorëve vlerësojmë se kemi luajtur një rrol aktiv në mbështetje të menaxhmentit në realizimin e objektivave të Kompanisë të përcaktuara në Planin e Biznesit të Ndërmarrjes si dhe duke zbatuar detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligjet në fuqi .

Me kënaqësinë me te madhe njoftoj aksionarin për të arriturat e kësaj kompanie gjatë vitit 2018 të cilat kanë qenë maksimale .Është arritur të realizohen të gjitha caqet e planifikuara të performances në Kompani .Nga autoriteti ARRU-ja KRU"Gjakova" ka arritur të rangohet e para nder kompanitë tjera të ujësjetës në Kosovë si më e suksesshmja ne arritjen e performances . Kjo arritje është rezultat i angazhimit të të gjithë të punësuarve ,stafit menaxherial ,zyrtarëve të lartë si dhe me implementimin e një qeverisje profesionale korporative nga KE-ja dhe ne si BD si dhe mbështetjes institucionale nga aksionari (Qeveria e Republikës së Kosovës).

Gjatë periudhës Janar–Dhjetor të vitit 2018, ne si Bord i Drejtorëve kemi zhvillua aktivitete të ndryshme të qeverisjes se korporative, bazuar në Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Aktivitet kryesorë në këtë aspekt përfshijnë aktivitetet e BD, dhe Komisionit të Auditimit.

Puna jonë është realizuar përmes mbledhjeve rregullta të Bordit ku janë trajtuar pika të zakonshme që përfshijnë vërtetimin e kuorumit , aprovimin e pikave të rendit të ditës, procesverbalin nga mbledhja paraprake e BtD , shqyrtimin e raportit të mbledhjes se Komisionit të Auditimit asi dhe informatën rreth aktiviteteve nga Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv. Raportet nga mbledhjet e Komisionit të Auditimit, janë prezantua si materiale në mbledhjet e rregullta te Bordit dhe janë dërguar në NJPMNP.Bordi i Drejtorëve i KRU-së duke mos dal nga suazat e kompetencave të saja si autoritet i emëruar për përfaqësimin e aksionarit, e plotësisht në harmoni me Ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës dhe në harmoni me interesat e aksionarit ka shqyrtuar qështje të rëndësishme të afarizmit të kompanisë duke e përmbyll zgjidhjen e çështjeve me Vendime dhe Qëndrime.

Vlen të theksohet se Bordi në realizimin e detyrave tona të besuara nga Aksionari –Qeveria e Kosovës në përmbushjen e objektivave të punës sonë dhe objektivave të të Kompanisë ,ka pas mbështetje të plotë nga zyrtaret dhe menaxhmenti profesional i Kompanisë .

Duke e përmbyllur këtë fjalë dhe duke iu referuar të dhënave, të cilat do të gjeni në këtë raport, kam kënaqësinë të përgëzoj Kryeshefin Ekzekutiv ,të gjithë menaxherët, zyrtarët dhe punonjësit e kompanisë tone për punën e zellshme që kanë bërë.Njëkohësisht një falënderim dhe mirënjohje e veçantë për të gjithë institucionet vendore dhe ndërkombëtare të cilat direkt apo indirekt kontribuan për suksesin tonë.

2.1 AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDERMARRJES

Në këtë pjesë të raportit do të pasqyrohen të dhënat për performancën e ndërmarrjes si dhe sfidat më të cilat jemi ballafaquar. Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes kanë qenë në realizimin e objektivave të planifikuara për vitin 2018 si dhe angazhimi në tejkalimin e pengesave dhe vështirësive tjera nga aktivitetet kryesore të ndërmarrja gjatë vitit 2018. Përkushtimi kryesor i Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2018 ka qenë arritja e caqeve të përcaktuara në Planin e Biznesit për këtë vit. Janë hartuar nga ekzekutivi dhe aprovuar nga BD një seri rregulloresh të cilat definojnë shumë procedura e çështje të brendshme të organizimit të punëve ,si dhe Planifikimi i Biznesit per periudhen 2019-2021.

Me knaqesinë më të madhe e raportojmë se këtë vit KRU"Gjakova" Sh.A. ka realizuar performanc pozitive në të gjithë treguesit e performances krahasuar me vitin 2017 dhe BP e vitit 2018 e që ne menyrë detale janë të prezentuara në kriteret e kerkuara si më poshtë ne këtë raport .

Administrative -janë hartuar dhe aprovuar një sërë rregullre të brendshme të Kompanisë ,manuale , si dhe akte tjera të cilat kanë bërë që puna të kryhet në menyrë profesionale dhe e bazuar në infrastrukturen ligjore të ligjeve në fuqi në Kosovë.

Raportet teknike ,financiare dhe administrative prezantojnë në mënyrë të përgjithshur të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga Kompania ,sa janë realizuar ato duke i prezantuar përmes tabelareve dhe diagrameve si dhe duke dhënë sqarime detale për të gjitha shifrat dhe faktet e prezantuara përmes raporteve teknike ,financiare dhe administrative.

Aktiviteti i Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit

Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2018 i ka mbajtur 12 Takime të rregullta me përbërje të plotë dhe 1 mbledhje të Aksionarit . Në kuadër të Bordit të drejtorëve funksionon edhe autoriteti i zgjedhur nga Qeveria -Komisioni i Auditimit i cili gjithashtu i ka mbajtur gjithsejtë (12 takime).

Është mbikëqyrë menaxhimi kompanisë dhe janë dhënë këshillat e nevojshme për Kryeshefin Ekzekutiv. Në takimet e rregullta janë mbikëqyrë të gjitha ecuritë e biznesit, mbarëvajtja e tyre sipas vendimeve të Bordit si dhe aspekti ligjorë i vendimeve të Menaxhmentit të kompanisë. Lidhur me këtë Bordi i Drejtorëve është i informuar për të gjitha vendimet dhe zhvillimet e rëndësishme. Bordi i Drejtorëve duke mos dalur nga suazat e kompetencave si autoritet i emëruar për përfaqësimin e aksionarit e plotësisht në harmoni me Ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës dhe në harmoni me interesat e aksionarit ka marr vendime me të cilat ka aprovuar :

Mbledhja BTB nr 27 -29.01.2018 u muarren këto Vendime me të cilën u aprovuan ;1)

Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Dhjetor 2017 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Gjakova "sh.a-Gjakovë ,2) Raporti IV Tetor - Dhjetor 2017 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Gjakova "sh.a-Gjakove. 3) kërkesa e KE dhe behet ndarja e departamentit shitjes nga departamenti financiar dhe ndryshohet Organogrami dhe Rregullorja mbi Organizimim dhe sistematizim te vendve te punes.

Mbledhja 28-28.02.2018 u muarren këto Vendime me të cilën u aprovuan ; 1)Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Janar 2018 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Gjakova "sh.a-Gjakove, **2)**kerkesa e KE per dhenien me qera te Objektit ne Dige deri ne 10 vite, **3)**kerkesa e KE per dhenien e Pelqimit per shfrytezimin e ndertimit te Mini hidrocentraleve ne KRU'Gjakova'sh.a-Gjakove **4)**plotesim ndryshimi nenit 5.1.4 te Rregullores per matjen dhe konsumitn e ujit RO5/2017,**5)**kerkesa per nderrimin e politikave kontabel ne KRU'Gjakova'sh.a-Gjakove.

Mbledhja Btd 29-07.03.2018 u muarren këto Vendime me të cilën u aprovuan; Aprovohet unanimsht Raporti Vjetor 2017 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste ne KRU'Gjakova'sh.a-Gjakove dhe i nejtj përcillet sipas afatit ligjor ne NJPMNP-MZHE

Mbledhja 30 -30.04.2018 u muarren këto Vendime me të cilën u aprovuan;1)Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Shkurt Mars 2018 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Gjakova "sh.a-Gjakove,**2)**Raportit final te Auditorit te Jashtem per vitin 2017 dhe Letra se Menaxhmentit te Auditorit Jashtem per vitin 2017 ne KRU'Gjakova'sh.a-Gjakove.

Mbledhja 31 30.05.2018 u muarren këto Vendime me të cilën u aprovuan; 1)Raporti TM3 Janar – Mars 2018 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Gjakova "sh.a-Gjakove, **2)**Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Prill 2018 mbi zvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Gjakova "sh.a-Gjakove, **3)**kerkesa e KE per shperblimin e punetoreve me rastin e Festes se Fiter Bajramit.

Mbledhja BtD 32 29.06.2018 u muarren këto Vendime me të cilën u aprovuan; ; 1.)Aprovohet unanimsht Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Maj 2018 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Gjakova "sh.a-Gjakove. **2.)** Aprovohet unanimsht Udhezuesi per Menaxhimin e Borgjeve te Keqija ne KRU'Gjakova"sh.a-Gjakove.**1)**Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Qershor 2018 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Gjakova "sh.a-Gjakove, **2)**raporti II-tremujor Prill-Qershor 2018 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste ne KRU'Gjakova'sh.a-Gjakove, **4)**propozimet e menaxhmentit per rishiqim te Plan Biznesit 2018-2020 ,**5)**kerkesa per shperblim te punetoreve te Kompanise ne vlere prej 50 euro

Mbledhja Nr:34 Data: 03.10.2018 u muarren këto Vendime me të cilën u aprovuan;1)Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Korrik-Gusht 2018 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Gjakova "sh.a-Gjakove,**2)**ngritja e te ardhruave personale ne perqindje prej 13% per te gjithë punetoret e KRU"Gjakovs"sh.a-Gjakove. Ngritja e te ardhurave vlen prej 1 Janar 2019,**3)**kerkesa e KZLF per shitjen e materilait jashte perdorimit, bashkangjitur dhe listen e materialeve.

Mbledhja Nr:35 Data: 24.10.2018 u muarren këto Vendime me të cilën u aprovuan;1)Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Shtator 2018 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Gjakova "sh.a-Gjakove,**3)**Plan Biznesi 2019-2021 ne KRU'Gjakova"sh.a-Gjakove ,**4)** Bordi Drejtoreve pas shqyrtimit dhe diskutimit te aprovoi kerkesen e Drejtorit Teknik per inkoprporim te pozitave te lartecekura.

Mbledhja Nr:36 Data: 29.11.2018 u muarren këto Vendime me të cilën u aprovuan;1)Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Tetor 2018 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Gjakova "sh.a-Gjakove,**2)** raporti tremujor mbi zhvillimin e aktiviteteve afarsite Korrik-Shtator 2018 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste ne KRU'Gjakova"sh.a-Gjakove ,**3)**Aprovohet ne parim dalja ne pension e punëtorëve 3 vite para moshes së pensionimit ,mirepo

paraprakisht të perpilohet një shkresë për MPMS lidhur me rregullimi e kesaj jqeshtje te kesaj kategorit te punesuarve , 4)Aprovohet unanimsht kerkesa e KE me nr protokolli 370

Mbledhja Nr:37 Data: 24.12.2018 u muarren këto Vendime me të cilën u aprovuan;1)Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Nentor 2018 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Gjakova "sh.a-Gjakove, 2)kerkesa e KE nese deri me 31 Dhjetor permbushien obliimet financiare te Kompanise ndaj opeatorit eknomik te Fazes se dyte, 3)Plani Investimeve afatgjate 2019-2028 ne KRU'Gjakova'SH.A.

Aktiviteti e Komisionit të Auditimit

Ndërsa Komisioni Auditimit i Kompanisë Rajonale "Gjakova"Sh.A ,komfor kompetencave të përcaktuara në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 , ka shqyrtuar qështjet e rëndësishme afariste të Kompani dhe ka marr këto .

Mbledhja KA 27 -25.01.2018 u muarren këto Vendime dhe Qendrim me të cilën u aprovuan; 1)raporti Procesi për Menaxhimin e Regjistrimit të Mjeteve Themelore, Stoqueve dhe Arkave ne KRU"Gjakova"sh.a-Gjakove përcillet tek dep financiar per zbatim ,2)Qëndrim-Draft raporti per menaxhimin e procesit te pergatitjes se Pasygrave Vjetore Financiare përcillet tek dep financiar per komente, 3)Qëndrim -Raporti mujor Janar 2018 performances operative financiare bashkangjitur me raportin e KE percillet per shqyrtim dhe aprovim ne mbledhjen e BtD, 4)Qëndrim -Raporti IV tremujor Tetor –Dhjetor 2016 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste percillet per shqyrtim dhe aprovim ne mbledhjen e BtD.

Mbledhja KA 28 26.02.2018 u muarren këto Vendime dhe Qendrim me të cilën u aprovuan;1)Vendim - Aprovohet unanimsht raporti Procesi për Menaxhimin e Regjistrimit të Mjeteve Themelore, Stoqueve dhe Arkave ne KRU"Gjakova"sh.a-Gjakove përcillet tek dep financiar per zbatim,2)Qëndrim - Draft raporti per menaxhimin e procesit te pergatitjes se Pasygrave Vjetore Financiare përcillet tek dep financiar per komente, 3)Qëndrim - Raporti mujor Janar 2018 performances operative financiare bashkangjitur me raportin e KE percillet per shqyrtim dhe aprovim ne mbledhjen e BtD,4)Qëndrim- Raporti percillet ne mbledhjen e Bordit Drejtoreve per aprovim ,5)Qëndrim- Kerkesat e KE te specifikohen per mbledhjen e Bordit,6)Qëndrim - Plotesim ndryshimi nenit 5.1.4 percillet per aprovim ne mbledhjen e Btd, 7)Qëndrim - Kerkesa per nderrimin e politikave kontabel percillet per aprovim ne mbledhjen e Bordit Drejtoreve.

Mbledhja KA 29 05.03.218 u muarren këto Vendime dhe Qendrim me të cilën u aprovuan;;1) Qëndrim - Raporti Vjetor 2017 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste ne KRU'Gjakova"sh.a-Gjakove përcillet per aprovim ne BtD,

Mbledhja 30 25.04.2018 u muarren këto Vendime dhe Qendrim me të cilën u aprovuan;1)Raporti final Raportin final Menaxhimi i Procesit të Përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Financiare" ne KRU'Gjakova'sh.a-Gjakove dhe përcillet per zbatim Departamentit Financiar 2)Qëndrim - Draft Raporti percillet per komente Stacionit te Filtrimit,3)Qëndrim - Raportet mujore Shkurt –Mars 2018 i Performancës Operative Financiare në KRU "Gjakova "SH.A.Gjakovë, Bashkangjitur me Raportin e Kryeshefit Ekzekutiv përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve,4)Qëndrim - Draft Raportin e Auditorit te Jashtem per vitin 2017 KRU'Gjakova'sh.a-Gjakove dhe Draft Letres se Menaxhmentit te Auditoret Jashtem per vitin 2017 Raporti percillet per aprovim ne mbledhjen e BtD.

Mbledhja KA nr 31 -28.05.2018 u muarren këto Vendime dhe Qendrim me të cilën u aprovuan;1)Raporti final "Menaxhimi i Procesit të Operimit në Stacionin e Filtrimit"ne KRU'Gjakova'sh.a-Gjakove 2)Aprovohet unanimisht" Manuali "Procesi i Operimit në Zyrën për Auditim të Brendshëm në K.R.U "Gjakova' sh.Gjakove , 3)Qëndrim -Raporti mujor Prill 2018 performances operative financiare bashkangjitur me raportin e KE percillet per shqyrtim dhe aprovim ne mbledhjen e BtD

Mbledhja KA nr 32 25.06.2018 u muarren këto Vendime dhe Qendrim me të cilën u aprovuan;1)Qëndrim -Draft raporti "Sistemi për Menaxhimin e Pasurisë Kapitale"" percillet per komente Njesise se Prokurimit dhe Dep Financiar ne KRU'Gjakova'sh.a-Gjakove,2)Qëndrim - Raporti mujor Maj 2018 performances operative financiare bashkangjitur me raportin e KE percillet per shqyrtim dhe aprovim ne mbledhjen e BtD

Mbledhja 33 25.07.2018 u muarren këto Vendime dhe Qendrim me të cilën u aprovuan;1) Raporti final Sistemi për Menaxhimin e Pasurisë Kapitale"ne KRU"Gjakova"sh.a-Gjakove dhe percillet per zbatim, 2)Vendim- omisioni Auditimit shqyrtoi dhe diskutoi Raportin Tremujor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm,3) Qëndrim - Raporti II-TM3 Prill-Qershor mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste ne KRU'Gjakova sh.a-Gjakove.percillet per aprovim ne mbledhjen e BtD 4)QËNDRIM-Raporti mujor Qershor 2018 i Performancës Operative Financiare në KRU "Gjakova "SH.A.Gjakovë, bashkangjitur me Raportin e Kryeshefit Ekzekutiv përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, 5)Qëndrim -Propozimet per rishiqim te Plan Biznesit 2018-2020 percillen per aprovim ne mbledhjen e Bordit Drejtoreve

Mbledhja 34 25.09.2018 u muarren këto Vendime dhe Qendrim me të cilën u aprovuan;1) Qëndrim - Draft raporti percillet per komente nga Menaxhmenti gjegjesisht sektori shitjes,2)Qëndrim - Raportet mujor Korrik-Gusht 2018 performances operative financiare bashkangjitur me raportin e KE percillet per shqyrtim dhe aprovim ne mbledhjen e BtD,3)Qëndrim - Kerkesa te plotesohet dhe me treguesit financiar , a mund te mbulohet financiarisht te shiqohet mesatarja e te ardhurave personale edhe ne Kompanite tjera dhe propozimi te jete me i qarte per mbledhjen e radhes 4)Qëndrim - Kerkesa te plotesohet per mbledhjen e BtD me Vendim te ri nga Komisioni per vleresimin e materialeve.

Mbledhja KA 35 22.10.2018 u muarren këto Vendime dhe Qendrim me të cilën u aprovuan;1)Aprovohet raporti final Sistemi per Menaxhimin e Procedurave te Faturimit -Dhjetor 2017 dhe periudha Janar –Qershor 2018 percillet per zbatim dep shitjes,2)Vendim-Aprovohen raportet te pikes 6.7.8 te zyres se Auditimit te Brendshem,3)Qëndrim -Raporti mujore Shtator 2018 te Performancës Operative Financiare në KRU "Gjakova "SH.A.Gjakovë, bashkangjitur me Raportin e Kryeshefit Ekzekutiv përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve,4)Qëndrim -Propozimet e menaxhmentit per draft Plan Binzesi 2019-2021 percillen per aporvim ne mbledhjen e BtD.

Mbledhja 36 u muarren këto Vendime dhe Qendrim me të cilën u aprovuan;1)Qëndrim - Draft raporti percillet per komente Njesise se Autoparkut,2)Qëndrim -Percillet per aprovim ne mbledhjen e Bordit Drejtoreve ,3)Qëndrim -Raportet mujor Tetor 2018 performances operative financiare bashkangjitur me raportin e KE percillet per shqyrtim dhe aprovim ne mbledhjen e BtD,4)Qëndrim -Kerkesa percillet per shqyrtim dhe diskutim ne mbledhjen e Bordit Drejtoreve dhe gjithashtu nje kerkese Minsitrise se Mlreqenies Sociale. Ne menyre qe most e kete ndeshje me Ligjin ,5)Qëndrim -Kerkesa nr 370 e KE percillet per aprovim ne mbledhjen e Bordit Drejtoreve

Mbledhja 37 Data: 20.12.2018 u muarren këto Vendime dhe Qendrim me të cilën u aprovuan;1)Qëndrim - Draft raporti percillet per komente Zyres se Prokurimit,2)Vendim - Aprovohet unanimsisht Raporti Final "Procesi për Menaxhimin e Autoparkut" ne KRU 'Gjakova'sh.a-Gjakove , 3)Vendim- Komisioni Auditimit pas shqyrtimi Raporti Vjetor 2018 te Auditimit te Brendshem muarr,4)Vendim- Aprovohet unanimsisht Raporti Vjetor 2018 te Auditimit te Brendshem 5)Vendim- Aprovohet unanimsisht Statuti i Zyres se Auditimit te Brendshem ,6) Qëndrim - Raportet mujor Nentor 2018 performances operative financiare bashkangjitur me raportin e KE percillet per shqyrtim dhe aprovim ne mbledhjen e BtD

2.1.2 Pasqyra e performances operative dhe financiare ne krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual

Bordi në mënyrë të rregullt ka vlerësuar parametrat e performances së Kompanisë. Krahasuar me vitin 2017 dhe Planifikimin e Vitit 2018, Kompania ka arritur që ti realizoi pothuajse të gjitha caqet e objektivave .

Pasqyra e performances operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual

<i>Treguesit kryesor te performances</i>	<i>Caqet e realizuara 2017</i>	<i>Caqet e realizuara 2018</i>	<i>Ndryshimi</i>	<i>Caqet e planifikuara BP 2018</i>	<i>Caqet e realizuara 2018</i>	<i>Ndryshimi</i>
1. Uji i prodhuar në m3	14,981,619	14,992,458	+10,842	14,004,902	14,992,458	+987,556
2. Uji i faturuar në m3	7,963,721	8,467,413	+503,682	7,562,647	8,467,413	+904,767
3. Konsumatorë të regjistruar	35,887	37,406	+1,519	37,440	37,406	-34
4. Nr. I faturave të lëshuara	35,887	37,406	+1,519	37,440	37,406	-34
5. Nr. I kons. që faturohen sipas	35,316	36,969	+1,653	36,961	36,969	+8
6. Uji faturuar për kons. me	7,439,297	8,112,059	+672,762	7,033,262	8,112,059	+1,078,797
7. Faturimi në Euro	4,034,672	4,431,934	+397,262	3,999,955	4,431,934	+431,979
8. Arketimi nga uji në Euro	3,512,467	4,196,351	+683,883	3,523,281	4,196,351	+673,070
9. Te hyrat tjera operative ne Euro	77,928	70,695	-7,232	60,000	70,695	+10,695
10. Shpenzimet operative	2,934,497	3,154,141	+219,644	3,058,366	3,154,141	+95,775
11. Shlyerja e borxheve ndaj kons.	373,256	0		0	0	
12. Shlyerja e obligimeve nga	0	0		0	0	
13. Parat e gatshme në bank dhe	583,425	293,609	-289,816	511,169	293,609	-217,560
14. Stoqet	536,522	604,966	+68,444	552,375	604,966	+52,591
15. Llogarit e arketueshme nga uji	10,926,268	11,025,209	+98,941	6,340,940	11,025,209	+4,684,269
16. Llogarit e pagueshme	8,117,330	11,723,930	+3,606,600	6,853,940	11,723,930	+4,869,990
17. Numri I punetoreve	260	265	+5	266	265	-1
18. Numri I ankesave	665	870	+205	600	870	+270
19. Numri total I testeve të	2,698	2,816	+118	1,335	2,816	+1,481
21. Matja e treguesve ne %						
22. Uji I pa faturuar	47%	43.5%	-4%	46%	43.5%	-2.5%
23. Përqindja e faturimit	100%	100%	0	99%	100%	+1%
24. Përqindja e konsumit të matur	93%	96%	+3%	93%	96%	+3%
25. Proporcioni I kons. Me ujmat	98%	99%	+1%	98%	99%	+1%
26. Efikasiteti I stafit	7.52	7.08	-0.44	7.10	7.08	-0.02%
27. Shkalla e inkasimit në % (të	87%	97%	+10%	88%	97%	+9%
28. Shkalla e inkasimit në % -	88%	92%	+4%	81%	92%	+11%
29. Shkalla e inkasimit në % -	83%	111%	+28%	87%	111%	+24%
30. Shkalla e inkasimit në % -	83%	107%	+24%	99%	107%	+8%
31. Norma e mbuleses së punes	1.26	1.35	+0.09	1.17	1.35	-0.18
32. Norma e punes	1.45	1.40	-0.05	1.33	1.40	+0.07
33. Shpenz.Operative per	6.60	7.03	+0.43	6.81	7.03	+0.22

Prodhimi i ujit në m3 -Prodhimi i ujit në vitin 2018, krahasuar me prodhimin e ujit gjatë vitit 2017 ka rezultuar me një rritje të vogël prej;10,842 m³, ndërsa krahasuar me BP ka gjithashtu një rritje prej; **987,556 m³**. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i terstimit të fazes së dytë dhe testimit të dy fshatrave Paluzh dhe Guri i Kuq. Falë kapaciteteve të prodhimit, kemi arritur të sigurojmë 24 orë ujë të pijes për konsumator, pastaj kemi bërë faturim me të lartë si dhe kemi zvogëlim të sasisë së humbjes së ujit të pijes për 3.5 % brenda vitit.

Faturimi në € -Në vitin 2018 faturimi në Euro është më i lartë se në vitin 2017 për **307,262** ndërsa krahasuar me BP 2018 ka rritje në vlerë prej 431,979 €. Në rritjen e Faturimit ka ndikuar leximi me i mir i ujematesve, ekipa e teknikes ne eliminimin e defekte ne kohe, puna e mir e kontrolles, puna e mir e ekipit te detektimit.

Arkëtimi në Euro – Në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, vlera e arkëtimit nga uji në Euro ka qenë për **683,883** euro me shumë,ndërsa për **673,070** më shumë se BP 2018.

Shpenzimet Operative -Në vitin 2018 kanë qenë për 219,644 se vitin 2017, kurse për -95,775më i lart se BP 2018, si rezultat i rritjes së aktivitetit të Kompanisë për ngritje të performances me kushte me të mira të punës. Ngritje ka shpenzimet e derivateve, kemikaleve dhe shpenzimet e ujit pasi kemi bërë kompenzim duke paguar faturimet vetanake.

Humbjet e ujit -Në vitin 2018, humbjet e ujit janë 43.5%,krahasuar me 2017 , prej 47% dhe BP 46%, kemi zvogëlim të humbjeve për 3.5%.

Fitimi operativ – Vitin 2018 e kemi mbyllur me Fitim operativ prej 1,112,905 euro. Krahasuar me vitin 2017 fitimi operativ në Euro ka qenë me i lart për 457,007 euro,qe ka ardhur si rezultat i rritjes të arkëtimit, kurse për 587,989 me i lart se BP 2018.

Nr. i punëtorëve- Në vitin 2018 krahasuar me Planin e Biznesit të vitit 2018 është më ulët për 1 punëtorë, ndërsa krahasuar me vitin 2017 ka pas 5 punëtor më shumë .

Nr. i testeve të dështuara - Në vitin 2018, i plotësojnë standardet e kërkuara sipas IKSHP. Numri i tyre gjithmonë tregon treguesin -0%.

Nr. i konsumatorëve- Në vitin 2018 krahasuar me numrin e konsumatorëve në vitin 2017 ka rezultuar me rritje prej 1,519 ndërsa krahasuar me BP 2018 numri i konsumatorëve ka rënë prej 34 konsumator.

Parat e gatshme në bankë dhe në arkë- Me 31.12.2018 paraja ka qenë 293,609 qe është për 298,816 më i ulët se në vitin 2017 dhe për 217,560 më pak se BP 2018, si rrjedhojë e rritjes të afarizmit në Kompani dhe pagesave të fundvitit (siç është faza e dytë e perpunimit të ujit).

2.1.3 Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes

Top çështjet tjera të cilat do mund të përcaktojnë të ardhmen e Kompanisë janë :

- Krijimi në vazhdimësi i kushteve më të volitshme të infrastrukturës ujore dhe të kanalizimit për konsumatorët tonë.
- Zgjidhja e çështjes financiare të obligimeve financiare të rregullta mujore ndaj ARRU-se, MMPH etj.
- Arkëtimi i borxheve të vjetra sipas Salldo 31.12.2017, sipas Ligjit në mënyrë të detyrues.
- Realizimin e Marrëveshjeve për borxhet e pa paguara, me konsumatorët borxhli për ri-Programim të borxheve ndaj KRU-së.

- Rritja e shkalles së Faturimit dhe arkëtimit të Faturave te vitit 2018 ne minimum +1.48 % te tyre nga konsumatorët dhe një pjese te Borxheve te pa paguara nga konsumatorët sipas Salldos 31.12.2017.
- Paisja me ujëmatës të mençur i të gjithë kategorive të konsumatorëve.
- Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale të ujit te pijes.
- Furnizimi me uji i fshatit Lubizhdë e Hasit nga Liqeni i Radoniqit.
- Zgjerimi i zonës së shërbimit në Dushkajë dhe Reken e mirë.
- Planifikimi për furnizim me uji i Rekes se Keqe.
- Lidhja e Marrëveshjeve të shërbimeve me konsumatorët.
- Përmirësimi i menaxhimit të sistemit të furnizimit me ujë, mbajtja nën kontroll e nivelit të prodhimit i cili nga ana tjetër është i lidhur me koston e prodhimit, në veçanti shpenzimet e energjisë elektrike të cilat shpenzime janë të lidhura direkt me nivelin e prodhimit, ulja e nivelit të prodhimit ndikon edhe në uljen e koston së këtyre shpenzimeve.
- Angazhimi maksimal i Sektorit të Planifikimit e Zhvillimit në hartimin e Projekteve investive kapitale, për aplikimin tek aksionari Qeveria e Kosovës, Donatoret, Bankat, etj.
- Realizimi me kohë i Projekteve
- Zhvillimi i raporteve të vazhdueshme me Institucionet vendore dhe donatoret nderkombetar.
- Rritjen e investimeve kapitale nga mjetet vetanake.
- Gatishmëria teknike dhe furnizimi i duhur me makineri të rëndë për nivelin e duhur të operatives.

2.1.4 Pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm

Kompania do të vazhdoi punën në vitin e ardhshëm në mirëmbajtjen dhe aktivitetin e avancimit të funksioneve të operimit si dhe do ti realizoi treguesit operativ dhe financiar sipas objektivave të përcaktuara në Plan Biznes 2019:

- Rritja e prodhimit të ujit për 15,758,606 m³,
- Zvogëlimi i humbjeve të ujit në rrjetë për-1.5 %
- Rritjen e sasisë së ujit të shitur,të faturuar për + 1.59 %
- Rritjene arkëtimit të faturuar në +1 %,
- Rritja e arkëtimit te borxheve ne masën prej +9%
- Rritjen e shpenzimeve jo operative për+ 4.05%
- Investime vetanake kapitale dhe nga donacionet ne vitin 2019 ne shume prej; 20,327,561 ku hyjn edhe investimet ne Impiantin e ujerave te zeza.

Në aspektin e aktiviteteve thelbësore të biznesit edhe në vitin 2019 do të vazhdojë me veprimet e duhura të punëve operatives në teren ;

Furnizimi i konsumatorëve me ujë cilësor,- mirëmbajtja e funksionalitetit të mbarë infrastrukturës,investime të planifikuara dhe aty ku mundë të shfaqen,e ku do të vlerësohet se mundë tëvihet në rrezik biznesi jonë.

Reduktimi në masë të madhe i rrezikut nga përmytjet nga kanalizimi fekal dhe gjatë periudhave me të reshura me intensitet dhe kohë të tejzgjatur.Me qëllim të sigurimit të cilësisë më të mirë të shërbimeve për klient, KRU-ja do të veprojë në favor të ndërmarrjes së masave të shpejta dhe efikase ndaj kërkesave të arsyeshme dhe nevojave tjera të klientëve .

Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për konsumatorët është një ndër detyrat kryesore të kompanisë. Në këtë drejtim angazhimi profesional nga ana e punëtorëve në një anë dhe investimet në rritjen e kapaciteteve të prodhimit, leximit-faturimit dhe inkasimit-arkëtimit

në anën tjetër, do të ndikoi në rritjen e besueshmërisë së KRU "Gjakova" Sh.A. tek konsumatorët, e që janë në pajtueshmëri të plotë me misionin dhe vizionin e Kompanisë.

Të arrijmë të përmbushim kërkesat dhe ankesat e konsumatorëve në afatin minimal të mundshëm.

Të mbuloj të gjitha kostot operative të Ndërmarrjes me përjashtim të amortizimit, me të ardhura nga parat e gatshme.

Do të bëjmë zvogëlimin e shpenzimeve të planifikuara për energji dhe karburante, si dhe do të bëjmë planifikimin e investimeve vetanake si dhe të aplikojmë për grante në Qeverinë e Republikës së Kosovës me projekte sipas planifikimit nga Sektori për Planifikim dhe Zhvillim.

Ngritja e të hyrave në periudhën vijuese mbledhja e borxheve nga vitet paraprake, do të mbetet një ndër prioritet më të larta të menaxhmentit. KRU-ja ka dy prioritet kryesore për të ngritur inkasimin-arkëtimin; **Përmes Marrëveshjeve për Ri-programimin e borxheve** në mes të KRU-së dhe konsumatorëve borxhli që të paguajnë borxhet e vjetra sipas Salldos 31.12.2017 dhe faturat mujore të vitit 2018, e në rast dështimi opsion i fundit do jetë zgjidhja e kësaj çështjeje përmes; **Arkëtimin të detyruar** përmes çkyqjes duke bere ckyqjen nga rrjeti dhe, **kërkesa për përbarimin e borxheve përmes Përbaruesit Privat**. Planifikohen që për vitin e fundit sipas LMD të percillen të gjithë konsumatorët borxhli të cilët nuk kanë paguar borgjet, tek përbaruesit privat.

Riorganizimi dhe ristrukturimi i punëve dhe detyrave të punës sipas organizimit dhe sistematizimit të ri të hartuar nga Ekipi i Konsulentëve në KRU "Gjakova".

Zhvillimin profesional të punëtorëve sipas Sektorëve të caktuar dhe të motivoi në arritjen e performancës së standardeve më të larta si dhe të krijojë një ambient të sigurt pune.

Do të vazhdojë me ndërtimin dhe zhvillimin e raporteve korrekte, në radhë të parë me aksionarin tonë Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe me palët e interesit posaçërisht me ARR, MZHE, MMPH, Kuvendet Komunale, Donatorët, etj.

2.2. Informacione në lidhje me kapitalin dhe dividendën

Rivlerësimi i aseteve në KRU "Gjakova" Sh.A.-Gjakovë, për herë të fundit është kryer nga vlerësues të jashtëm në vitin 2007. Në pajtim me ligjet e aplikueshme, ky proces është kryer përmes një kompanije të licencuar për vlerësim dhe atë paraprakisht të lejuar nga Aksionar. Kapitali themelor i Ndërmarrjes në momentin e regjistrimit ka qenë 25.000 € aksione me vlerë nominale prej 1 € secili. Aksionar i vetëm i K.R.U. "Gjakova" Sh.A. Gjakovë është - Qeveria e Republikës së Kosovës.

Të gjitha ndryshimet e kapitalit themelor, bëhen sipas përcaktimit në Ligjin Nr.02/L123 "Për Shoqëritë Tregtare" ku përfshihet shuma-parapagimi, raporti me vlerën nominale, rritja e kapitalit themelor, zvogëlimi i kapitalit themelor, ndarja e aksioneve, rigrupimi i aksionit, anulimet që nuk ndryshojnë kapitalin themelor, riblerja ose revokimi i aksionit.

Struktura e Kapitalit	Kapitali Aksionar në Euro
Kapitali aksionar në para	25,000
Rezervat e rivlerësimit	31,573,654
Humbjet e bartura	-121,988
Fitimit financiar e vitit 2018	126,918
Total ekuiteti dhe kapitali	31,603,584
Bilanci deri me 31.12.2018	31,603,584

2.2.1 Kredit e rëndësishme të nënshkruara apo të paguara gjatë vitit

Gjatë vitit 2018 nuk kemi hyrë në marrëdhënie të reja kreditore .

2.2.2 Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2018

KRU "Gjakova " Sh.A. gjatë vitit 2018 ka bërë investime të shumta bazuar në planin e tij zhvillimor. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2018 janë realizuar me rregull dhe sipas afateve siç janë përcaktuar në Planin e Biznesit dhe në planin individual të Sektorit për Zhvillim dhe Projekte investive. Më poshtë janë përmendur projektet investive dhe burimet e financimit të projekteve në mënyrë të përgjithësuar, ndërsa statusi i tyre dhe detajet janë pjesë e këtij raporti. Gjatë vitit 2018 Kompania ka investuar në projektet e paraqitura në vijim nga mjetet e realizuara nga; donatorët, mjetet vetanake, dhe nga donacionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës;

Me investimet nga Donacionet është bërë realizimi i projekteve:

Investimet nga donacionet e KFW, Qeverisë ,CDI ,Komunave dhe vetanake për vitin 2018

- **Lot 1:** Linja e ujit te pijes nga baseni i Radoniqit, linja e Anadrinit , linjat dhe infrastruktura mbështetëse, Faza e dytë. *Totali i donacionit* - Për 2018: **685,997.83 €**.
- Projekti LOTI 2 "Linja e unit te pijes nga baseni i Radoniqit, linja e Anadrinit , linjat dhe infrastruktura mbështetëse, Faza e dytë. *Totali i donacionit* - Për 2018: **764,020.56 €**.
- Projekti LOTI 3 Kanali Derivues i Bazenit të Radonqit, Linja dhe Infrastruktura Mbështetëse është financuar nga MZHE në Totalin e Donacionit -Për 2018 :**316,550.19€**
- Eliminimi i ujërave të ndotura në JP të Kosovës faza III, "Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Gjakovë, tenderi nr. **KFW/BMZ201365501/** Gjakovë PH - III / WC-1", ndrrimi i kolektoreve 1& 2, vlera e kontrates baze: 3,695,933.26, pagesa per vitin 2018 nga KFW : **1,297,867.13 €**
- Rehabilitimi i sistemeve rurale të ujësjellësit në zonën e shërbimit të KRU " Gjakovë " Sh.A Gjakovë, për të gjitha fshatrat te investuara nga CDI Lot 1.
- Ndrimi i gypit shtytës te Stacioni i pompimit në Bregdri dhe paisjeve përcjellëse në rezervuar dhe ndërtimi i stacionit të pompimit me rezervuar në Palluzhë për KRU "Gjakova" SH.A. Gjakovë me nr. të prokurimit KRURGJA-18-4391-5-2-1& KRURGJA-18-015-5-2-1, në vlerën prej : **128.852,55 €** me TVSH, pjesa e participimit të Komunës së Rahovecit është prej 49% të vlerës së projektit (Pjesa e Polluzhës) nga punët e kryera **27.739,64 €**, pjesa e participimit KRU "Gjakova" është 51% **101.112.91€**.

TOTALI: për 2018 :3,064,435.71 €.

Tabelari – Projektet e realizuara nga Donacioni nga Qeveria e Kosovës ,CDI ,Komuna për vitin 2018

Emri i Projektit	Vlera Euro	Operatori Ekonomik i kontraktuar
Lot 1:Linja e ujit te pijes nga baseni i Radoniqit, linja e Anadrinit , linjat dhe infrastruktura mbështetëse, Faza e dytë Lot 2:Linja e ujit te pijes nga baseni i Radoniqit, linja e Anadrinit , linjat dhe infrastruktura mbështetëse, Faza e dytë. Lot 3 :Kanali derivues I basenit te Radoniqit, linja dhe infrastruktura mbështetëse	Mjete vetanake 1,466,568.46€ Donacioni nga K.K. Gjakovë 134,194.91€ K.K. Prizren 100,000.00€ K.K. Rahoveci 65,805.21€ Totali i donacionit Për 2018 1,766,568.58€	"PEVLAKU" shpk Kontrata te realizohet per 3 vite kalendarike realizohet në vlerë: LOT- 1 2,272,026.82 € LOT- 2 2,813,936.48 € LOT- 1 1,943,459.03 € TOTALI 7,029,422.40 €
Përfundimi i punimeve të ujësjellësit për 28 fshatra - Gjakovë	Donacioni nga MPPH Totali i donacionit - Për 2018 200,000.00 €	"KWE" Mitrovicë Kontrata të Realizohet per 180 dite pune me vlerë: 2,173,820.84 €
Rehabilitimi i sistemeve rurale të ujësjellësit në zonën e shërbimit të KRU " Gjakovë " Sh.A Gjakovë, për të gjitha fshatrat te investuara nga CDI Lot 1. dhe Lot 2	Donacioni nga DORCH/CDI Totali i donacionit të realizuar - Për 2018 360,402.28 €	KWE Kontrata bazë në vlerë: Lot 1 537.456,59 € Puna + Materiali 155,232.00 € Gypat 523,265.00 € Totali lot 1 1,216,039.50 € Totali lot 2 235,569.63 € 1,441,609.13 €
Ndrrimi i gypit shtytës te Stacioni i pompimit në Bregdri dhe paisjeve përcjellëse në rezervuar dhe ndërtimi i stacionit të pompimit me rezervuar në Palluzhë për KRU "Gjakova" SH.A. Gjakovë .	Në vlerën prej : 128.852,55 € me TVSH, pjesa e participimit Komunes së Rahovecit është prej 49% të vlerës së projektit (Pjesa e Polluzhës) nga punët kryera 27.739,64 €, pjesa e participimit KRU "Gjakova" është 51% 101.112.91€.	NTP "XËRXA" Kontrata bazë: 128.852,55 € me TVSH
Eliminimi i ujërave të ndotura në JP të Kosovës faza III, "Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Gjakovë, tenderi nr. KFW/BMZ201365501/ Gjakovë PH - III / WC-1"	Ndrrim i i kolektoreve 1& 2 Kontrata bazë: 3,695,933.26 Gjatë vitit 2018, janë paguar: 1,297,867.13 €	Kosova Water & Energy sh.p.k Kontrata bazë: 3,695,933.26
TOTALI 2018:	3,753,690.54 €	

Investime vetanake të Kompanisë me participim ne projekte te financuara nga Qeveria e Kosovës është bërë realizimi i projekteve

Emri i Projektit	Vlera Euro	Operatori Ekonomik i kontraktuar
Lot 1:Linja e ujit te pijes nga baseni i Radoniqit, linja e Anadrinit , linjat dhe infrastruktura mbështetëse, Faza e dytë Lot 2:Linja e ujit te pijes nga baseni i	Mjete vetanake 1,466,568.46 Donacioni nga K.K. Gjakovë 134,194.91 K.K. Prizren 100,000.00	"PEVLAKU" shpk Kontrata te realizohet per 3 vite kalendarike realizohet në vlerë: LOT- 1 2,272,026.82 €

Radoniqit, linja e Anadrinit , linjat dhe infrastruktura mbështetëse, Faza e dytë. Lot 3 :Kanali derivues I basenit te Radoniqit, linja dhe infrastruktura mbështetëse	K.K. Rahoveci	65,805.21	LOT- 2	2,813,936.48 €
	Totali i donacionit		LOT- 1	1,943,459.03 €
	Për 2018	1,766,568.58	TOTALI	7,029,422.40 €
Totali - Për 2018		1,766,568.58 €		

Gjithsejtë investime vetanake në projekte ne participim me Qeverinë dhe komunat Prizren Gjakovë dhe Rahovec: 1,766,568.58 €

1,466,568.46 € +300,000.12€ = 1,766,568.58€

Foto nga Impiantet e trajtimit të ujit të pijes 1 & 2



Të gjitha projektet janë kryer brenda afatit optimal, kurse Komisioni i BtD për projekte kapitale ka përcjell statusin e projekteve gjatë mbledhjeve që janë mbajtur gjatë vitit 2018

Projekti: Eliminimi i ujërave të ndotura në JP të Kosovës faza III, "Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Gjakovë, tenderi nr. KFW/BMZ201365501/ Gjakovë PH - III / WC-1"

Mbikëqyrja e ndërtimit përfshin dy kontrata të punëve si vijojnë:

- Kontrata e Punëve 01 (WC-01): Rehabilitimi dhe Zgjerimi i Rrjetit të Kanalizimit Gjakova bazuar në FIDIC Librin rozë (Pink Book)
- Kontrata e Punëve 02 (WC-02): Impianti dhe dizajni-ndërtimi i ITUN Gjakova bazuar ne FIDIC Librin e verdhe (Yellow Book).

Është nënshkruar kontrata me Operatorin Ekonomik Kosova Water – Energy sh.p.k, me datë: 31 Maj 2018. Me datë: 11.10.2018, ka filluar ekzekutimi i punimeve në rrugën "Ymer Pula", afër urës së Moglicës.

Kontrata e Punëve 01:

Më 31 maj 2018 është nënshkruar kontrata WC – 01 me Kontraktuesin Kosovo Water & Energy, me seli në Prishtinë/Kosovë.

Me 25 Qershor 2018, dorëzimi i Sigurimit të Ekzekutimit nga kontraktori i WC – 01, pasuar nga lëshimin Letrës së Fillimit të njëjtën ditë.

Incizimet në terren duke përfshirë investigimin për kyçjet shtëpiake kanë filluar më 09 korrik 2018 dhe kanë konfirmuar vlerësimet e Konsulentit para përpunimit të Dokumenteve të

Tenderit, se rreth 90% e familjeve në rrjetin e Kanalizimeve kanë lidhur jo vetëm ujërat e sanitare, por edhe çatitë dhe drenazhimet e parcelave.

Numri i rritur i kyçjeve të gabuara shtëpiake dhe rrjedhimisht korrigjimet janë marrë parasysh gjatë përpunimit të Dokumenteve të Tenderit. Vlerësimet janë konfirmuar kur kontraktuesi filloi testet me tym dhe ngjyrë më 09 shtator 2018.

Megjithatë, ndarja e ujërave atmosferike nga ujërave sanitare është e mundur vetëm nëse pronarët janë të gatshëm të ndajnë edhe drenazhimin e parcelave përkatëse. Radoniqi po sensibilizon pronarët e parcelave në një fushatë shtëpi për shtëpi për të ndarë ujërave atmosferike nga ujërat sanitare, duke propozuar kështu financimin dhe realizimin e kyçjes së veçantë nga kufiri i parcelës deri në kolektorin përkatës.

Si pjesë e Vizatimeve të Ekzekutimit, kontraktuesi është duke propozuar shkyçjen e të gjitha shkarkimeve të ujit atmosferik dhe rikyçjen e të gjitha kyçjeve të ujërave sanitare në rrjetin e kanalizimeve, duke përdorur pusetat inspektuese, nëse kërkohet (më shumë se një kyçje familjare në të njëjtën pusetë). Sidoqoftë, identifikimi i saktë i kyçjeve familjare në mënyrë të duhur/jo të duhur kërkon kohë dhe është bazë e të gjitha punëve të ndërtimit që vijojnë. Megjithatë, Kontraktuesi ende nuk e ka tejkaluar afatin kohor të dhënë në Dokumentet e Tenderit dhe, rrjedhimisht, në kontratë.

Më 11 tetor 2018 kontraktori filloi punimet fizike në rrugën Ymer Pula dhe vazhdoi në Rrugën Uashingtoni. Në total janë shtrirë 114 m tubacione DN 500, 569 m tubacione DN 400 dhe 335 m tubacione DN 350, duke çuar kështu në një gjatësi prej 629 m tubacione të shtrira në periudhën aktuale raportuese.

Kontrata e punës 02:

Pas dhënies së "mos-kundërshtimit" nga KfW në Raportin për Vlerësimin Financiar më 15 Qershor 2018, Komisioni i Vlerësimit filloi me negociatat e kontratës, pra në lidhje me kontratën kryesore dhe për më tepër, me kërkesë të KfW, për zëvendësimin e dezinfektimit nga dezinfektimi me klor në atë me rreze Ultra Violete (UV).

Aktivitetet në periudhën aktuale raportuese në lidhje me WC 02 - Impianti dhe Projektimi-Ndërtimi i ITUN Gjakova, janë kufizuar në negocimin e kontratës, që kanë qenë i gjatë dhe shterues, me ofertuesin e ranguar i pari PASSAVANT, duke çuar kështu në nënshkrimin e kontratës përkatëse më 21 nëntor 2018.

Sidoqoftë, Procedura e Tenderit në lidhje me WC – 02 përfshirë negociatat e kontratës dhe në fund nënshkrimi i kontratës përkatëse është pjesë e procedurës së tenderimit dhe për këtë arsye ende nuk përbën subjekt të këtij Raporti .

Me datë: 21 Nëntor 2018, është nënshkruar kontrata me OE – PASSAVANT Energy & Environment. Vlera e kontratës është: **7.27 Milion €**

Nr.	Projekti	Investuesi	Emërtimi dhe numri i kontrates	Punëmarrësi /numri fiskal	Arsyeshmeri a e projektit	Vlera e kontrates /€
1	Eliminimi i ujërave të ndotura në JP të Kosovës faza III	KFW SECO Komuna e Gjakovës	Eliminimi i ujërave të ndotura në JP të Kosovës faza III (BMZ No. 2013 65 501) Rehabilitimi dhe Zgjerimi i Rrjetit të Kanalizimit Gjakovë Nr. Tenderit: KFW /BMZ 2013 65-501/Gjakova/PH-	Kosova Water & Energy sh.p.k Nr. fiskal 601126560	Trajtimi i Ujerave te Zeza, Mbrojtja e burimeve nentokesore te ujit dhe permiresimi i shendetit te popullates	3,695,933.26

	III/WC1		
Punimet e realizuara gjatë muajit Tetor-Dhjetor 2018 Kolektori nr. 1 & 2	Instalimi i gypave kryesor në kolektorin nr. 1. (DN 500 = 0 m) (DN 400 = 219 m) (DN 350 = 0 m) në total = 219 m.	Gjithsejt deri tani: 31.12.2018	
	Instalimi i gypave kryesor në kolektorin nr. 2. (DN 500 = 0 m) (DN 400 = 0 m) (DN 350 = 170 m) në total = 170 m.	Kolektori 1&2 (DN 500 = 114 m) (DN 400 = 569 m) (DN 350 = 335 m) Në total = 1,018 m.	
	Kolektori nr.1. Instalimi i pushtave të betonit 8 copë, Instalimi i pushtave inspektuese 0 copë, Kolektori nr.2. Instalimi i pushtave të betonit 5 copë, Instalimi i pushtave inspektuese 0 copë,	Betoni: 32 copë Inspekt: 5copë	
	Kolektori nr.1. Instalimi i lidhjeve të kanalizimit shtëpiak 9 kycje Kolektori nr.2. Instalimi i lidhjeve të kanalizimit shtëpiak 14 kycje	Total: 75 lidhje	

Foto gjatë aktiviteteve te ndrrimit te kolektorëve



Ekipa e KRU Gjakova gjatë inspektimit të projektit



Ekipa e KRU Gjakova gjatë inspektimit të projektit



Foto- Realizimi i projekteve gjatë zhvillimit të punimeve



Investimet kapitale për përmirësimet infrastrukturore dhe jo infrastrukturore të realizuara gjatë vitit 2018 me investime vetanake dhe Grand Qeveritar

Nr.r.	Përmirësimet infrastrukturore dhe jo infrastrukturore	Te realiz.2018
1.	Bimet shumëvjeçare dhe shkurret	48.206
2.	Objektet ndertimore	449.270
3.	Rrjeta e ujësjellesit	527.583
4.	Ujmatësit	58.086
5.	Investime në projekte	762
6.	Investime në rrjetin e Kanalizimit	2.474
7.	Pajisje elektrike-mekanike	255.801
8.	Kamionat dhe automjetet	549.891
9.	Pajisjet kompjuterike	15.056
1	Pajisje për zyrë	1.676
1	Faza e dytë e përpunimit të ujit	5.956.901
	GJITHSEJTI:	7.865.706

Këtë vit në kontabilitet kemi kapitalizuar komplet vlerën e investuar për fazën e dytë, pasi deri me tani ka qenë i regjistruar si Investim në Vijim. Pasi të pranohet teknikisht dhe të kryhen punët komplet, kapitalizohet.

2.2.3 Dividentet e paguara gjatë vitit

Gjatë vitit 2018 nga KRU "Gjakova", nuk është kërkuar të paguajnë dividend nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

2.3 TË DHËNAT PËR DREJTORËT JO EKZEKUTIV

2.3.1 Emrat e drejtorëve të bordit të drejtorëve gjatë vitit ,duke përfshirë kompensimet ,shpenzimet dhe pagesat për shërbimet e ndërmarrjes

Sipas Vendimit nr. 05/54 të datës 24.10. Bordi i Ndërmarrjeve Publike në KRU "Gjakova", Sh.A.- ka mbetur me përbërje të njëjt si më poshtë ;

Fatos Koshin	Kryesues i Bordit të Drejtorëve . Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2018 - neto 4,668 €.
Arbresha Kuqi	Anëtar i Bordit të Drejtorëve si dhe Kryetari i Komisionit të Auditimit. Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2018- neto 4,439€
Isuf Asllani	Anëtar i Bordit të Drejtorëve . Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2018- neto 3,317 €
Xhevdet Morina	Anëtar i Bordit të Drejtorëve si dhe anëtarë i Komisionit të Auditimit. Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2018 - neto 4,141€
Shpat Mejzini	Anëtar i Bordit të Drejtorëve . Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2018 - neto 3,319 €,
Zeqir Fetoshi	Anëtar i Bordit të Drejtorëve si dhe anëtar i Komisionit të Auditimit. Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2018 -neto 4,141€,

2.3.2 Numrin e takimeve të bordit gjatë vitit dhe numrin e pjesëmarrjes së drejtorëve në takimet e bordit

Gjatë vitit 2018 Bordi i Drejtorëve i K.R.U. "Gjakova", Sh.A-Gjakovë ka mbajtur ;Mbledhje të rregullta gjithsejtë 12 mbledhje dhe Mbledhja e përgjithshme të Aksionarit 1 mbledhje. Mbledhjet e Bordit janë vijuar në mënyrë të rregullt nga të gjithë Drejtorët jo-ekzekutiv dhe Drejtori Ekzekutiv. Në përgjithësi vijimi i mbledhjeve vlerësohet me pjesëmarrje të rregullt të Bordit të Drejtorëve

2.3.2 Komisioni i Auditimit ,Komitet , përbërja e tyre dhe numrin e takimeve të mbajtura

Komisioni i Auditimit që nga formimi i tij ka qenë mjaft aktiv, konstruktiv dhe frytdhënës, duke shqyrtuar, diskutuar dhe duke marrë vendime shumë të rëndësishme, në aspektin e mbarëvajtjes dhe ngritjes së performancës së përgjithshme të kompanisë.

Komisioni i Auditimit gjatë këtij viti ka mbajtur gjithsejtë 12 takime të rregullta, ndërsa shumë çështje tjera janë shqyrtuar drejtpërdrejt në takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve.Në vazhdim, paraqesim në mënyrë kronologjike, takimet, aktivitetet, diskutimet, konkluzionet dhe vendimet e Komisionit të Auditimit të cilët kanë diskutuar dhe analizuar; - Raportin financiar, për tremujorin e parë e deri në tremujorin e katërt të vitit 2018; Raporti vjetor i punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2017; - Aprovimi i planit strategjikë 2019-2021 dhe planit vjetor të Auditorit të brendshëm për vitin 2018. Konkluzionet dhe vendimet e marra të K.A:

- Komisioni i Auditimit aprovon raportet financiare të prezantuar nga Zyrtari Kryesor Financiarë të Kompanisë ,mujore Tremujore dhe Vjetore ,me sugjerimet dhe vërejtjet e dhëna që i propozohet Bordit ,Planin strategjikë të auditorit të brendshëm për vitin 2018, në bazë të propozimit të auditorit të brendshëm sipas nevojës të bëhet ndonjë auditim shtesë ,aktiviteteve të Auditorit të Brendshëm si dhe auditimet lidhur me raportet e tij te realizuara ne bazë të Planit të punës së tyre .

3.1 NGJARJET KRYESORE TË VITIT

3.1.1 Arritjet kryesore

Si arritje kryesore vlen të theksohen :

- KRU "Gjakova " Sh.A.- është vlerësuar në Raportin e vlerësimit të treguesve të performancës nga ARRU-ja , si kompania mjaft e suksesshme në arritjen e treguesve operativ dhe financiar të performances .
- Raporti i Vlerësimit të cilësisë së ujit të pijes nga IKSHPK -ja. Cilësia e ujit është vlerësuar e kualitetit të lartë dhe që i plotëson të gjitha kriteret e caktuara me akte nga IKSHPK .
- Vazhdimi i rritjes së numrit të portoarkave në disa lagje me dendësi më të madhe të konsumatorëve si dhe realizimi i Marrëveshjeve për Riprogramim të borxhit ,Kontratave të shërbimit si dhe sukcesi i inkasimit te mjeteve permes Permbaruesve privat .
- Krahasuar me vitin 2017, (1478-konsumator), në vitin 2018,numri i konsumatorëve të rinjtë regjistruar arrin në 1519 konsumator, kemi rritje të konsumatorëve të rinjë për 41, krahasuar me vitin 2017.
- Vazhdimi i zbulimit të keqpërdorimeve të mëdha nga konsumatorët e pandërgjegjshëm si dhe përcjellja e lendeve si Kallëzim Penal tek Prokurori i Shtetit për zhvillimin mëtutje te procedurës për ngritjen e Aktakuzës .Ky aktivitet është duke ndikuar dhe në masë të madhe në zvogëlimin e numrit të keqpërdoruesve si dhe zvogëlimin e humbjeve të ujit si dhe avancim në këtë drejtim të këtij treguesi të performances .
- Hartimi dhe aprovimi i Planit të Biznesit 2019-2021
- Hartimi i Planit për Investime Afatgjata 2019-2028 për KRU Gjakova,
- Takimi me stafin menaxhues të Kompanisë kontrollimi i objekteve ,pastrimi ,renovimi si dhe testimi i tyre ,kontraktimi me shfrytëzuesit e shërbimeve tona ,aktivitet në inkasim disiplina dhe përgjegjësit në punë.
- Takimet e rregullta me stafin e kompanisë ne lidhje me gjendjen e infrastruktures së ujit ,vështirësit problemet e paraqitura
- Formimi i grupit punues për ndihmë të inkasantëve në teren me qëllim të rritjes së shkalles së inkasimit .
- Perpilimi i shkresave dhe kerkesave per institucione lokale dhe qendrore
- Dergimi i shkresave ne MZHE per subvencione ne investime kapitale
- Takimet me zyrtaret e Komunave me të cilën operon Kompania ;Gjakovë , Rahovec dhe Prizren .
- Pregaditja e materialeve dhe e mbledhjeve të rregullta të BD .Mbajtja e mbledhjes vjetore me aksionarin se bashku me BD ,menaxhimi i punëve të përditshmesë bashku me menaxhmentin e kompanisë .
- Mbajtja e takimeve të rregullta me përfaqësues të fshatrave me qëllim të senzibilizimi të tyre me qëllim që ti kryejne obligimet financiare ndaj kompanisë

- Me datë: 31 maj 2018, është nënshkruar kontrata me OE, Kosova water Energy SHPK për Projektin Eliminimi i ujërave të ndotura në JP të Kosovës faza III, Projektit- "Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Gjakovë, (ndrrimin e kolektorëve 1& 2) , në vlerë financiare 3,695,933.26 €. Punimet kanë filluar me datë: 11.10.2018.
- Me datë: 21 Nëntor 2018 është nënshkruar kontrata me OE – PASSAVANT Energy & Environment. Vlera e kontratës është: 7.27 Milion €
- Realizimi me sukses i Projektit - Ekzekutimi i fabrikës – faza II-të, Vlera e projektit 7,021.000€, Projekti-Përfundimi i punimeve të ujësjellsit për 28 fshatra -Gjakovë. Vlera financiare: 2,173,820.84 €. Projekti-Rehabilitimi i sistemeve rurale të ujësjellësit në zonën e shërbimit të KRU " Gjakova " Sh.A Gjakovë, për të gjitha fshatrat te investuara nga CDI, Projekti-Aktivitetet e zvogelimit të ujit të pafaturuar për KRU "Gjakova" Vlera investive 123,782.50 €, Projektit-Ndrrimi i gypit shtytës te stacioni i pompimit ne Bregdri dhe pajisjeve perçjellese ne rezervar dhe ndertimi i stacionit te pompimit me rezervar ne Palluzh për KRU "Gjakova" SH.A. Gjakovë.Vlera investuese 128,852.55 €. Pjesa e Palluzhes është bashkëfinancuar me Komunën e Rahovecit.

3.1.2 Çështjet kyçe që janë paraqitur gjatë vitit

Si çështje kyçe që kanë ndodhë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Kompanisë gjatë vitit 2018 vlen të përmendet ;

- Programimi i Marreveshjes per borgjet e Ndermarrjes ndaj MMPH per shfrytëzimin e lejes ujore
- Pregaditjet rreth inaugurimit të Projektit të Impianitit te Ujit te pijes Faza e II-të
- Hartimi dhe Implementimi i Planit zhvillimor i Kompanisë 2018 – 2020 . Rishqyrtimi i këtij plani në periudhen Gusht 2018 në disa tregues të performances që aludohet në bazë të kapacitetit që ka kompania ta realizoi.
- eshte mbajte mbledhja e pergjithshme vjetore me akcionarin ku pjesemarres ne kete takim ishin edhe perfaqesuesit e MZHE dhe keshilltari Minsitrit z.Lluka u diskutuan qeshtjet qe kane te bejne me fusheveprimtarine e Kompanise
- Vazhdimi i implementimit të Marrëveshjes për zbatimin e projektit për eliminimin e ujërave të zeza në Komunën e Gjakovës. Aktivitetet ne plotësimin e procedrave administrative tek autoritet komunale dhe qeveritare per fillimin e punimeve janë në përfundim ..
- Vazhdimi i Instalimi i ujëmatësave familjare ne qytet dhe fshatra
- Me konsulentet eshte punuar rreth hartimit te akteve te brendshme të Kompanisë ; Manuali i Personelit ,Manuali i Shitjes dhe MArredhenjes me konsumator ,Struktura organizative ,pershkrimi i detyrave te punes dhe struktura e pagave etj ne vazhdim .
- Vazhdimi i hapjes së pikave të reja të arkëtimit ,në lagjet e qytetit si dhe në zonat rurale në tërë regjionin të cilin e mbulon Kompania .
- Vazhdimi i aktivitetit rreth përmirësimit të menaxhimit të sistemit të furnizimit me ujë ,mbajtja nën kontroll e nivelit të prodhimit I cili nga ana tjetër është I lidhur me koston e prodhimit ,në veçanti shpenzimet e energjisë elektrike të cilat shpenzime janë të lidhura direkt me nivelin e prodhimit, ulja e nivelit të prodhimit ndikon edhe në uljen e koston së këtyre shpenzimeve.
- Hartimi i planeve dhe projekteve për zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale të ujit te pijes,Hartimi i Projekteve për aplikimin tek aksionari–Qeveria e Kosovës, ulja në masë e shpenzimeve operative,
- Përfundimi i Projekteve ; - Ekzekutimi i fabrikës – faza II-të , Projekti-Rehabilitimi i sistemeve rurale të ujësjellësit në zonën e shërbimit të KRU " Gjakova " Sh.A Gjakovë, për të gjitha fshatrat te investuara nga CDI; Projektit-Ndrrimi i gypit shtytës te stacioni i pompimit ne Bregdri dhe pajisjeve perçjellese ne rezervar dhe ndertimi i stacionit te pompimit me rezervar ne Palluzh për KRU "Gjakova" SH.A. Gjakovë.Vlera investuese 128,852.55 €.Pjesa e Palluzhes do te bashkëfinancohet me Komunën e Rahovecit.

- Ka vazhduar ekzekutimi i Projekteve "Perfundimi i punimeve të ujësjellsit për 28 fshatra - Gjakovë. Vlera financiare: 2,173,820.84 € ; Projektit-Aktivitetet e zvogelimit të ujit të pafaturuar për KRU "Gjakova" Vlera investive 123,782.50 €, Projektit-Elementimi i ujërave të ndotura në JP të Kosovës faza III, Projektit- "Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Gjakovë.
- Marrja në shfrytëzim për 15 vite e paluajtshërisë tek pika e zezë për ndertimin e objekteve percjellese të operativës teknike
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik në një takim të organizuar me Ndermarrjet u diskutuan qeshtjet të rëndësishme dhe problemet të ndërlidhura me funksionimin e këtij sektori publik .U shtruan çështjet e përbashkëta që e rëndojnë sektorin e Ujësjellësve e që kërkojnë zgjidhje urgjente nga Qeveria e Republikës së Kosovës janë;Rastet sociale-kategoria e konsumatorëve të KRU-ve (Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale-MF-MZHE), Taksa Ujore e pa paguar (falja e borxheve të KRU-ve) dhe cmimi për shfrytëzimin e resursit Ujor (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-Fondi i Ujërave),
- Me autoritetin ARRU –në u shtrua dhe u diskutua Amandamentimin e Rregullores Nr. 02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimit, me theks të veçantë nën 36 dhe 37.
- Në takimin e organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kemi marr pjesë në takimin tonë kushtuar kushteve ujore për impiantin për trajtimin e ujërave të ndotura, Fsh. Marmull, K. Gjakovë,
- Me 28 shkurt 2018 në tryesën e organizuar nga Instituti GAP i cili ka analizuar efektet e Ligjit për faljen e borxheve, i cili ka hyrë në fuqi më 3 shtator 2015 dhe ka përfunduar në shtator 2017. Në këtë analizë janë përfshirë të dhëna nga 11 ndërmarrje publike dhe dy institucione shtetërore për borxhin e falur deri më 2008, borxhin e mbledhur për periudhën 2009-2014 si dhe shkallën e inkasimit për vitet 2015 dhe 2016. Me qëllim të identifikimit të kategorive përfituese të qytetarëve, kjo analizë përmban edhe të dhëna të mbledhura nga një anketë me 1,000 qytetarë.
- Përmes SHUKOS-it e me propozimet tona është kërkuar nga të dhënat për Objektet Fetare , të zgjidhet përmes ligjit , si të jetë modeli i nënit të ligjit .
- Së bashku me zyrën zvicerane me kryetarin Ardian Gjini dhe Azra Krasniqi nga AF Consulting konsulence e angazhuar nga Sekretariati për Çështje Ekonomike i Qeverisë Zvicerane është kërkuar që të realizohet një studim lidhur me mundësinë e implementimit të masave të eficientës së energjisë në ujësjellës.
- Me qëllim që Kompania të ketë të hyra në buxhetin e saj përmes procedurave ligjore jep në shfrytëzim disa hapsira të objektit në Digë si restorant .
- Vizita e delegacionit si Projekt Menaxheres Elke Dullenkopf dhe Uwe Arras Esnior Inxhinier me rastin e qëndrimit të tyre në Kosovë .Ky delegacion i bënë vizit Kompanisë , dhe qëllimi i kesaj vizite ishte shqyrtimi i progresit të projekteve.
- Kemi marrë pjesë edhe në takimin e mbajtur më datën 25.05.2018, të kuvendit XVII-të SHUKOS ku u bë miratimi i dokumenteve të Kuvendit (Plani i punës 2017, Raporti Financiar 2017, Plani i Punës 2018, Buxheti 2018).
- Është bërë nënshkrimi i marrëveshjes së grantit në mes të Qeverisë së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW), për financimin e projekteve "Mënjanimi i ujërave të zeza në Kosovën Jugperëndimore - FAZA V
- Më datë 19.06.2018 është vendosur gurethemeli për projektin Ndërtimi Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Zeza në zonat urbane të Qytetit të Gjakovës, projekti i financuar nga Komuna e Gjakovës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës së bashku me Qeveritë e Gjermanisë dhe Zvicrës
- Me ceremoninë e prezantimit të Raportit të Performancës për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë, për vitin 2017 të organizuar në Vila Gërmia në Prishtinë , KRU"Gjakova" Sh.A. për të 6 vit me radhë shpallet si Kompania me performancën më të mirë në nivel qendror.
- Në kuadër të serisë së punësive që po organizon SHUKOS në bashkëpunim dhe me përkrahjen e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike si dhe të Sekretariatit të Këshillit Ndërmnistror për Ujëra për standardet teknike dhe udhëzuesit e hartuar nga Grupi Punues Ndërinstitucional

- për Cilësinë e Ujit të Pijshëm kemi marr pjesë në punëtorinë e radhës. Punëtorja është mbajtur me Menaxherët e Cilësisë së Ujit të Pijshëm të KRU-ve dhe në të është elaburuar dhe diskutuar dokumenti: Procedurat e veprimit në rastet kur cilësia e ujit nuk përputhet me vlerat parametrike
- Me 5. Korrik 2018 është organizuar takimi nga Udh. I Ekipit të Programit I RWSSP Faza e VI-të Z. Alan Braun Takimi me drejtorët e KRU-ve në kuadër të "Programit mbështetës për Ujësjetllës dhe kanalizime në zonat rurale Faza e VI –të . Qasja Gjithpërfshirëse në Ujë të Pijshëm dhe Sanitacion & Marrëdhëniet me Konsumatorë , Operimi dhe Mirëmbajtja në Sistemet Rurale, Zvogëlimi i Ujit të Pa-faturuar
 - Përmes SHUKOS-it , kemi diskutuar dhe kemi dhënë komente lidhur me ndryshimet e inicuar te Projektligjit te Ndërmarrjeve Publike. Është kërkuar që deri me datën 16.07.2018, te analizohet këtë Projektligj ,janë bere komentet ,dhe pastaj është bërë harmonizimi i qëndrimeve te përbashkëta te KRU-ve për dhenjen e Komenteve.
 - Nga SHUKOS për Albena Reshitaj, Ministre e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor (Shoqata e Ujësjetllësve dhe Kanalizimit të Kosovës) I përcillet një shkresë /Kërkesë për problemet rreth ; Lejet Ujore, taksat Ujore, borxhet e vjetra të taksës ujore të KRU-ve dhe I propozojnë këtij autoriteti ; vazhdimin e lejeve Ujore për KRU-te, ashtu që te bëjnë marrëveshje për pagese me këste te këtyre borxheve te vjetra ,ne afat kohor me te gjate te përballueshëm financiar , që afatet e lejeve Ujore te vlejné 10 vite ,duke pas për baze konsultimin dhe mundësinë Ligjore sipas Ligjit te Shërbimit te Ujit Nr.05/L-042, sipas te cilit Licencat mund te kenë afat deri ne 10 vite, brojtja e Burimeve Ujore.
 - Në takim të përbashkët me Kabinetin e Ministrit MMPH Kompanitë Regjionale të Ujësjetllësit, "ARRU" dhe "SHUKOS", në të cilin ka marrë pjesë edhe ministri Zhvillimit Ekonomik z. Valdrin Lluka ku është arritur marrëveshje mes MMPH-së dhe Kompanive Regjionale të Ujësjetllësit (KRU) për borxhin e akumuluar prej vitit 2007- 2017 nga këto kompani.Takimi i përbashkët solli këto konkluzione:1.)Kompanitë Regjionale të Ujësjetllësit (KRU) në aftat prej 5 (pesë) vitesh të paguajnë borxhin që kanë ndaj MMPH-së prej 1.585.654.370 euro duke filluar në muajin shtator 2018 me 20 për qind për të vazhduar edhe katër vite të tjera, me nga 20 për qind të pagesës. 2)Kompanitë Regjionale të Ujësjetllësit (KRU) nuk mund të pajisen me leje ujore nga MMPH-ja në rast të mos pagesës prej 20 për qind të borxhit në muajin shtator, 3)Kompanitë Regjionale të Ujësjetllësit (KRU) në rast të aplikimit për leje ujore në MMPH, duhet të bashkëngjisin edhe faturën e pagesës së borxhit prej 20 për qind , 4)Kompanitë Regjionale të Ujësjetllësit (KRU) në rast të mos zbatimit të marrëveshjes me MMPH-në për kthimin e borxhit, mund tu merret Leja Ujore dhe për pasojë edhe licenca e operimit nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, 5)Nga ARPL-ja dhe Zyra Ligjore është kërkuar hartimi i një draft-marrëveshje për çdo KRU veç e veç dhe pastaj të ftohen përfaqësuesit e Kompanive për nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve.
 - Nga KWF Banka – Premtim Islami bashkangjitur nga autoriteti na është përcjell marrëveshja e veçantë për Programin V te ujerave te zeza. Marrëveshja financiare është nënshkruar dhe ratifikuar me ministrinë e financave. Kjo marrëveshje është grant prej 8 milion eurove për tre qytetet Peja, Gjakova dhe Prizreni.
 - Permes SHUKOS-kemi marr pjesë në takim ku pjesëmarrës i ftuar ishte edhe Ministri Valdrin Lluka në takim ku u diskutuan çështje të rëndësishme ; Për hartimin e projektit të KRU-ve "Ujëmatësit Smart ",vlerësimi i aseteve te KRU-ve "Fushat vetëdijesuese për Ujin ",Njoftim për konferencen Ballkanike të Ujrave .
 - Me date 19.09.2018 - u bë nënshkrimi I Marrëvshjes për Programimin e Borxhit në mes të KRU-ve dhe MMPH-së per obligimin e pageses se tarifes se shfrytëzimit të ujit me shumicë nga Liqeni i Radoniqit .
 - Nga sawa office menaxhment Me 25 Shtator 2018 është mbajtur work shopi me agjendën e diskutimit pse kërkohej menaxhimi industrial I Ujërave të zeza .Implementimi ne KRUGjakova , Opinionet e Institucioneve : Komunave , ARRU,MESP .

- Nga ARRU-ja përmes Drejtorit Z. Preteni ne ceramoninë e ndarjes së Licencave të Sherbimit ,Kompania ka marr Licencen e shërbimit edhe per 8 vite në vijim .
- Me 05 Tetor 2018 është mbajt takimi i organizuar i Shukos-Shukalbit me Tirane ku në ditën e parë të konferencës u prezantuan Raportim i përgatitjeve të Ekspozitës, Statusi i Regjistrimeve në Ekspozitë , Planimetria e Ekspozitës , Statusi i Sponsorizimeve , Programi i Konferencës , Raport mbi Abstraktet e dorëzuara , Temat për Sesionet Plenare , Dita e parë e Konferencës (8 nëntor 2018) , në ditën e dytë (9 nëntor 2018), u prezantuan ; Çmimet që do të ndahen gjatë Pritjes së Mirëseardhjes, Eventi Social (8 nëntor 2018), Workshopet Para-Konferencë (7 Nëntor 2018), Programi i Përbashkët i Trajnimit SHUKALB-SHUKOS , Kurset e Trajnimit, Programet e D-LeaP , Efiçenca Komerciale, Efiçenca e Energjisë, Humbjet e Ujit, Menaxhimi i Aseteve , Plani i sigurisë.
- Me 16.10.2018 është vizituar KRU"Gjakova " SH.A. nga KWF Banka me agjendën dhe rendin e ditës ne lidhje me Projektin Impianti I Ujërave të Zeza ne Jugperëndim të Kosovës Faza e III , V dhe VI të.
- 19 Nëntor 2018 kemi marr pjesë në Ceremoninë për inaugurimin e impiantit rural për trajtimin e ujërave të zeza -sistem lagunar- në Kramovik, Rahovec për realizimin e Projektit GEF "Mundësimi i Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore në Pellgun e Zgjeruar të Lumit Drin", implementuar nga UNDP në bashkëpunim me GWP-Med dhe UNECE ku u bë Prerja e Shiritit inaugurues dhe u bë Prezantim i strukturës dhe funksionimit të impiantit .
- Nga data (26.-27.11.2018) Elke Dullenkopf dhe Uwe Arras kanë bërë nje vizite dy ditore ne Kosove 26-27 Nëntor. Në KRU"Gjakova " është bërë vizita me datë 26.11.2018 . Qëllimi I vizitës ishte vlerësimin e projektit te ri ne ujerat e zeza programi VI. Objektivi I këtij projekti është rehabilitimi I rrjetit ne tre qytete Peje, Gjakove dhe Prizren ne vlere prej 9 milion eurove grant.

3.2 PASQYRË E PËRFORMANCES OPERATIVE TEKNIKE DHE INDIKATORET KYÇ TË PËRFORMANCES

3.2.1 Niveli i shërbimeve të ndërmarrjes (të saktësohet në vlera volumi i aktivitetit) gjegjësisht indikatorët fizik

Prodhimi i ujit

Gjatë vitit 2018 ,prodhimi i ujit është realizuar në përputhje me kërkesat e konsumatorëve për ujë. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur reduktime të rregullta të ujit. Prodhimi i ujit ishte normal dhe i ka plotësuar kërkesat për furnizim me ujë, pandërprere për të gjitha zonat furnizuese, me orar të plotë 24 orë.

Në vitin 2018 është prodhuar $14,992,458 \text{ m}^3$, sasi kjo më e rritur për $10,842 \text{ m}^3$ në krahasim me vitin 2017, ku prodhimi ka qenë $14,981,616 \text{ m}^3$, ku nga kjo sasi e prodhuar janë faturuar gjithsejtë $8,467,413 \text{ m}^3$.

Ne këtë prodhim të raportuar janë të dhënat edhe për burimet e ujit në: Hoqë të Madhe, Oterushë, Senoc, Drenovc, Demjan 1 & 3, dhe Greqinë 1,2,3).

Tabela - Uji i prodhuar, uji i faturuar, uji i pa faturuar dhe humbjet gjatë vitit 2018, krahasuar me 2017 dhe BP 2018

Treguesit	Viti 2018	Viti 2017	Ndryshimi	%	Viti 2018	BP 2018	Ndryshimi	%
Prodhiimi m ³	14,992,458	14,981,619	-10,839	-0.07%	14,992,458	14,004,902	987,556	6.59%
Faturimi m ³	8,467,413	7,963,721	-503,692	-5.95%	8,467,413	7,562,647	904,766	10.69%
Pa faturuar m ³	6,525,045	7,017,898	492,853	7.55%	6,525,045	6,442,255	82,790	1.27%
% humbjes	43.52%	46.84%	3.32%		43.52%	46.00%	-2.48%	

Diagrami - Uji i prodhuar, uji i faturuar, uji i pa faturuar dhe humbjet gjatë vitit 2018, krahasuar me 2017 dhe BP 2018





Tabela - Uji i prodhuar gjatë vitit 2018 krahasuar me vitin 2017 dhe BP 2018

Prodhiimi i ujit	Te realizuara 2018	Te realizuara 2017	Ndryshimi 2018 me 2017	BP 2018 te realizuara	Te realizuara 2018	Ndryshimi 2018 me BP
Janar	1,108,406	1,309,339	-200,933	1,304,553	1,108,406	196,147
Shkurt	1,078,365	1,246,527	-168,162	1,285,853	1,078,365	207,488
Mars	1,110,366	1,322,696	-212,330	1,287,454	1,110,366	177,088
Prill	1,163,062	1,289,873	-126,811	1,287,508	1,163,062	124,446
Maj	1,207,713	1,287,187	-79,474	1,288,081	1,207,713	80,368
Qershor	1,241,589	1,243,417	-1,828	1,286,413	1,241,589	44,824
Korrik	1,286,920	1,287,438	-518	1,283,949	1,286,920	-2,971
Gusht	1,361,104	1,256,363	104,741	1,203,608	1,361,104	-157,496
Shtator	1,372,751	1,225,837	146,914	1,189,024	1,372,751	-183,727
Tetor	1,330,185	1,216,332	113,853	1,170,265	1,330,185	-159,920
Nëntor	1,350,791	1,183,936	166,855	1,160,254	1,350,791	-190,537
Dhjetor	1,381,206	1,112,674	268,532	1,088,301	1,381,206	-292,905
Totali:	14,992,458	14,981,619	10,839	14,835,263	14,992,458	-157,195

Paraqitja grafike e Prodhimit të ujit në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017



Nga kjo sasi e ujit të prodhuar **14,992,458m³**, sasia e ujit të faturuar është **8,467,413 m³** kurse humbjet e ujit janë 43.5% apo 3.5% më të ulëta se një vit më parë.

Arsyet kryesore të humbjeve të ujit janë: Rrjeti i amortizuar i gypave, defektet në rrjetin e ujësjellësit, ujëmatësit e vjetruar mbi 10-30 vjeçar, leximi jo i sakte dhe i jo i rregullt i ujëmatësve të disa konsumatorë, keqpërdorimet në rrjet nga ana e konsumatorëve, kyçje ilegale nga disa konsumator të pandërgjegjshëm, etj.

Ardhja e ujit në Liqe

Gjatë vitit 2018, mbushja e Liqenit të Radoniqit me ujë nga Lumi i Lumbardhit të Deçanit, është bërë gjatë periudhës së paraparë me planin dinamik të mbushjes.

Në fillim të vitit: 01.01.2018, niveli i liqenit ka qe në kuoten 450.50 m , ndërsa në fund të vitit me; 31 Dhjetor 2018, niveli i liqenit ka qenë 451.60m, që është 0.38 metra më i lartë se një vit më parë pra në vitin 2017 (451.22 m), në të njëjtën datë. Duke u bazuar në vitet e mëparshme mendojmë se edhe këtë vit do të arrijmë të mbushim liqenin në nivelin maksimal deri në fillim të sezonit veror.

Sasia e ujit në Janar – Mars 2018, ishte 0.22 m³/sec deri 6.56m³/sec ,ndërsa në Mars- Qershor ardhja e ujit ishte deri nga 6.56-4.16 m³/sec. Me datë ;20.03.2018, niveli i Liqenit arriti në maximum pra në kuotën 456 m . Me datën;27.03.2018, ka filluar edhe kapërderdhja e liqenit e cila ka vazhduar deri në gjysmen e muajit Korrik, me datë: 14.07.2018, me nivelin 456.6 m.

Vëllimi i Liqenit në Fillim të muajit Janar 2018, ka qenë 91,877,062 m³ ndërsa në fund të vitit me 31.12.2018 ka qenë: 94,255,233 m³.

Me datë: 19.10.2018, ujitja e ka ndërprerë marrjen e ujit nga Liqeni për vitin 2018, dhe gjatë kësaj periudhe ka shpenzuar uji nga liqeni (Prill-Tetor) 35,741.088 m³.

Me përlllogaritjet tona resurset ujore në liqe janë rimbushur rreth 78% e sasisë së tërësishme akumuluese, nëse llogariten derdhjet nga minimumi biologjik .

Kualiteti i ujit-2018

Uji i prodhuar në vazhdim është nën kontroll dhe i plotëson standardet e kërkuara nga Rregullorja për kualitet të ujit nga I.K.SH.P dhe bazuar në numrin e mostrave bakteriologjike dhe mostrave kimike gjatë muajit Janar 2018, uji ka qenë sipas normativës së kërkuar për të gjitha zonat furnizuese të KRU" Gjakova", duke respektuar Udhëzimin Administrativ nr. 16/2012 për cilësinë e ujit për konsum nga njeriu.

Gjatë kësaj periudhe një vjeçare , Janar-Dhjetor 2018, ishim në kontakt me ISHP dega në Gjakovë ku e kemi konfirmimin me shkrim të analizave të ujit për pije të KRU "Gjakova" i plotëson kriteret për ujë të pijshëm dhe se analizat Bakteriologjike dhe fiziko-kimike janë NEGATIVE.

Në laboratorin e Stacionit të Filtrimit janë bërë po ashtu analizat interne për kontrollin e kualitetit të ujit. Analizat fiziko kimike bëhen çdo 2 dhe 24 orë pa ndërprerë, ndërsa ato bakteriologjike 1 herë në muaj, si dhe marrja e mostrave në rrjetin furnizues (analizat bakteriologjike dhe fiziko kimike në 12 pikat kryesore, nga pika më e afërt deri te pika e fundit).

Mostrat merren në rrjetin e Qytetit të Gjakovës, Rahovecit, furnizimi i fshatrave në Prizren, dhe burimet tjera si (Demjan, Greqinë, Optrush, Drenovc dhe Sinovc).

Tabela - Analizat e Ujit gjatë muajit Janar –Dhjetor 2018, krahasuar me vitin 2017:

Vitet	2018		2017				
Muaji	Analizat Mikrobiologjike	Analizat Fiziko-Kimike	Analizat Mikrobiologjike	Analizat Fiziko-Kimike	Total 2018	Total 2017	Ndryshi mi
Janar	102	102	164	164	204	328	210
Shkurt	94	94	147	147	188	294	-106
Mars	94	94	156	156	188	312	-124
Prill	95	95	126	126	190	252	-62
Maj	120	120	90	90	240	180	60
Qershor	104	104	89	89	208	178	30
Korrik	120	120	100	100	240	200	40
Gusht	151	151	102	102	302	204	98
Shtator	131	131	88	88	262	176	86
Tetor	128	128	96	96	256	192	64
Nëntor	139	139	93	93	278	186	92
Dhjetor	130	130	98	98	260	196	64
Totali:	1408	1408	1349	1349	2816	2698	(+) 1325

Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit

Gjatë Vitit 2018, ekipi i mirëmbajtjes së rrjetit të ujit të pijes në tërë sistemin që përfshin qytetin e Gjakovës me Fshatra si dhe Njësinë e Rahovecit dhe Njësinë e Lumbardhit, me angazhim të plotë dhe përkujdesje e ka bërë mirëmbajtjen e rrjetit dhe eliminimin e defekteve që paraqiten në rrjetë ku kryesisht janë defekte të natyrave të ndryshme dhe dimensioneve të ndryshëm e në rastet më të shpeshta janë defektet në rrjetin nga materiali i Azbest-Cementit. Defektet gjatë këtij viti janë kryer me kohë sidomos është respektuar koha e kryerjes së defekteve që të jetë sa më e shkurtë në mënyrë që të ndikohet në zvogëlimin e humbjeve që janë akoma të larta.

Gjatë muajt Janar 2018, kemi bërë edhe sanime te gypave qe kan qenë në defekte të mëdha apo edhe shtrirje të rrjetit te ri me te hyra vetanake nga KRU "Radoniqi" në një gjatësi mbi 285 m nga; Ø 63- Ø90, në një vlerë mbi: 7.500 €.

Investimet jane realizuar në; Gjakovë në Rugen Fan Noli L= 105m Ø 90, dhe fshatin Osek Hile, L=150m, Ø 5/4 ,dhe ne Rahovec, Rruga Halil Hamza L=30m Ø 5/4.

Gjatë muajt Shkurt 2018,, kemi bërë edhe sanime te gypave qe kan qenë në defekte të mëdha apo edhe shtrirje të rrjetit te ri me te hyra vetanake nga KRU "Gjakova".

Është bërë ndrrimi i gypit në një gjatësi L=904 m, PE 100 RC DN Ø 250/16bar dhe L=285 m Ø 63 /10 bar. Pastaj në fshatin Krajk, instalimi i gypit te ri ne një gjatesi L=450 m PE 100 DN Ø 110.

Gjatë muajt Mars 2018,, kemi bërë edhe sanime te gypave qe kan qenë në defekte të mëdha

apo edhe shtrirje të rrjetit të ri me te hyra vetanake nga KRU "Gjakova". Është berë ndrrimi i gypave në fshatin Xerxe L= 30m Ø 1 col dhe ne fshatin Bitesh L=40m Ø ¾, në Gjakovë eshte dislokuar gypi L= 50 m Ø 63. Gjatë muajt Prill 2018, kemi berë edhe sanime te gypave qe kan qenë në defekte të mëdha apo edhe shtrirje të rrjetit të ri me te hyra vetanake nga KRU "Gjakova". Është berë ndrrimi i gypave në Rrugen Yjet e Erenikut L= 80m Ø 110 dhe Rrugen Deshmoret e Lirisë L= 60m Ø 63 , pastaj në Rahovec, Rruga e Uçk L=35m Ø 40 dhe Fshatin Fortesë L=91m Ø 63. Gjatë muajt Maj 2018, kemi berë edhe sanime te gypave qe kan qenë në defekte të mëdha apo edhe shtrirje të rrjetit të ri me te hyra vetanake nga KRU "Gjakova". Është berë ndrrimi i gypave në fshatin Meqe L= 150m dhe ne fshatin Xerxe L= 171 m. Gjatë muajt Qershor 2018, kemi berë edhe sanime te gypave qe kan qenë në defekte të mëdha apo edhe shtrirje të rrjetit të ri me te hyra vetanake nga KRU "Gjakova". Është berë intalimi i gypit L= 600 m Ø 63, ne hapsirat gjelbruese te Stacioni i Filtrave, dhe ndrrimi i gypit per kemikale L= 90m Ø 5/4. Me datë: 18.07.2018, kemi pasur pelcitje te gypit GRP Ø 1100, në fshatin Lugbunar, ku ekipa e mirëmbajtjes ka arritur ta sanojë brenda 14 orëve, ku vonesa ka qenë kryesisht nga problemi me zbrazen e ujit nga gypi, ku llogaritet një humbje e ujit të përpunuar prej 8500 m³. Gjithashtu në fund të muajit Korrik, kemi filluar me testimin e gypit kryesor nga Rugova deri ne Kabash në stacionin e pompave dhe nga aty ne gypin shtytes prej 1900m DERI NE rezervarin e Lubizhdes ku kemi bere klorinimin , dezinfektimin e gypave dhe analizat gjegjëse fiziko-kimike dhe bakteriologjike dhe kemi bere zbrazen e gypave dhe rezervarit 2 herë, dhe kemi një humbje të ujit të përpunuar prej 4.470 m³. Gjatë muajt Korrik 2018, kemi berë edhe sanime te gypave qe kan qenë në defekte të mëdha apo edhe shtrirje të rrjetit të ri me te hyra vetanake nga KRU "Gjakova". Është berë intalimi i gypave në : fshatin Lipovec L= 50 m, Ø 63, fshatin Gerqinë, L= 200 m, 1 col, fshatin Cermjan, L= 50m, 1 col, fshatin Sopot, L= 15 m, Ø 5/4, në Gjakovë, Rr. S.Stavileci, L= 10m, Ø 63. Gjatë muajt Gusht 2018, kemi berë edhe sanime te gypave qe kan qenë në defekte të mëdha apo edhe shtrirje të rrjetit të ri me te hyra vetanake nga KRU "Gjakova". Është berë intalimi i gypit në lagjen Sadik Stavileci Ø90 me gjatesi 200 m. Gjatë muajt Shtator 2018, kemi berë edhe sanime te gypave qe kan qenë në defekte të mëdha apo edhe shtrirje të rrjetit të ri me te hyra vetanake nga KRU "Gjakova". Është berë intalimi i gypit të ri në fshatin Lugbunat L= 420 m, Ø 63, fshatin Rezina L= 2050, Ø 125 dhe Rr, Petronin Luarasi L=227 m, Ø 90 dhe 63. Gjatë muajt Tetor 2018, kemi berë edhe sanime te gypave qe kan qenë në defekte të mëdha apo edhe shtrirje të rrjetit të ri me te hyra vetanake nga KRU "Gjakova". Është berë intalimi i gypit të ri në fshatin Piran L= 100 m, PE DN Ø 63, dhe fshatin Fortesë L= 30m PE DN Ø 90. Gjatë muajt Nëntor 2018, kemi berë edhe sanime te gypave qe kan qenë në defekte të mëdha apo edhe shtrirje të rrjetit të ri me te hyra vetanake nga KRU "Gjakova". Është berë intalimi i gypit të ri në fshatin, Lipovec L= 600m Ø 5/4 mm, Rr. Anton Qeta ndrrim gypi L= 65 m, Ø63 mm, Rr. Washingtoni L=120m, Ø63mm dhe ne Rahovec," Ndrrimi i rrjetit i ujsiellsit ne fsh.Fortes. L = 30(m) PE 5/4 Ømm, ndrrimi i rrjetit i ujësjellsit ne rr.Faheredin Hoxha L = 37 (m) PE Ø22mm dhe ndrrimi i rrjetit i ujsiellsit ne rr.Bekim Isma L = 62,21(m) PE 5/4 Ømm.

Numri i defekteve (nga Ø ½ ÷ Ø 65mm dhe Ø 65mm ÷ Ø1100mm) për periudhën vjetore Janar – Dhjetor 2018, është 2416 defekte për 3 Njësit punuese: Gjakovë ,Rahovec, Lumbardh.

Deri ne fund të muajit Dhjetor 2018, gjatësia e rrjetit të ujësjellsit sipas shërbimit gjeodezik ne ArcGIS, është: 771,608.587m, apo 771.61 kilometra.

Duke llogaritur në gjatësinë e rrjetit prej **771,608.587m**, numri i defektet te paraqitura në një km, është barazi me **3.13 defekte në km/vit.**

Tabela –Totali i Numrit të defekteve ne Nj. Gjakovë , Rahovec dhe Lumbardh

Vitet		2018			2017		
Muajt	nen 2 col	Mbi 2 col	Gjithsejtë defekte	nen 2 col	Mbi 2 col	Gjithsejtë defekte	Ndryshimi
Janar	133	16	149	268	128	396	(247)
Shkurt	133	19	152	217	28	245	(93)
Mars	147	30	177	259	46	305	(128)
Prill	196	17	213	232	34	266	(53)
Maj	178	31	209	258	31	289	(80)
Qershor	168	26	194	243	40	283	(89)
Korrik	185	25	210	200	31	231	(21)
Gusht	171	30	201	173	26	199	2
Shtator	178	48	226	145	22	167	59
Tetor	199	36	235	210	34	244	(9)
Nëntor	183	40	223	166	36	202	21
Dhjetor	186	41	227	140	26	166	61
Totali:	2,057	359	2,416	2,511	482	2,993	(577)

Mirëmbajtja dhe ndërrimi i ujëmatësve,

Këtu janë rastet kur inkasatët i lajmërojnë rastet e prishjeve ,bllokimit të ujëmatësve nga copat e gurit,thyerje e ndonjë dhëmbëzore ,bllokimi në zonat e ulëta nga zalli,si dhe ndërrimi i xhamave nga ngricat si pasoj e mos izolimit të ujëmatësve në sezonin e dimrit . Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018, është ndërruar dhe riparuar kjo sasi e ujëmatësve . Këtu janë rastet kur inkasatët i lajmërojnë rastet e prishjeve ,bllokimit të ujë matësve nga copat e gurit,thyerje e ndonjë dhëmbëzore ,bllokimi në zonat e ulëta nga zalli,si dhe ndërrimi i xhamave nga ngricat si pasoj e mos izolimit të ujëmatësve në sezonin e dimrit , por janë vendosur ujëmatësa edhe te konsumatorët të cilet nuk kanë pasur ujëmatësa dhe janë faturuar paushall.

Tabela-Ujëmatës të rij dhe të pastruar gjatë vitit 2018,krahasuar me vitin 2017

Vitet	2018			2017			Ndryshimi 2018/2017		
Muajt	Ujëmatës të ri	Servisim i ujëmatësve	Ndërrimi i xhamave	Ujëmatës të ri	Servisim i ujëmatësve	Ndërrimi i xhamave	Ujëmatës të ri	Servisim i ujëmatësve	Ndërrimi i xhamave
Janar	92	24	7	49	30		43	(6)	7
Shkurt	96	23	5	30	7		66	16	5
Mars	96	20	1	43	38	11	53	(18)	(10)
Prill	82	12	9	26	8	5	56	4	4
Maj	30	3	-	15	16	2	15	(13)	(2)
Qershor	75	10	9	15	16	2	60	(6)	7
Korrik	129	12	1	30	25	1	99	(13)	-
Gusht	28	11	-	22	7	1	6	4	(1)
Shtator	52	8	7	13	6	9	39	2	(2)
Tetor	106	12	3	19	25	6	87	(13)	(3)
Nëntor	87	2	2	17	5	12	70	(3)	(10)
Dhjetor	81	15	2	17	44	2	64	(29)	-
Totali:	954	152	46	296	227	51	658	(75)	(5)

Paraqitje të reja të konsumatorëve gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2018


Nga paraqitjet vullnetare të konsumatorëve për legalizimin e lidhjeve të reja, si dhe puna e grupave të kontrolles në teren me evidentimin e konsumatorëve të cilët mbajnë lidhje jo legale kompania arrin që në vitin 2018, të kemi rritje të konsumatorëve për +1519 konsumator, me kontrata për shërbime të nënshkruara në të tri Njësitë (Gjakovë, Rahovec, Lumbardh).

Krahasuar me vitin 2017, (1478-konsumator), në vitin 2018, numri i konsumatorëve të rinjtë regjistruar arrin në 1519 konsumator, kemi rritje të konsumatorëve të rinjë për 41, krahasuar me vitin 2017.

Tabela - Paraqitje të reja të konsumatorëve gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2018, krahasuar me periudhen e njejte te vitit 2017

Muaji	2018	2017	Ndryshimi
Janar	82	57	25
Shkurt	135	93	42
Mars	-144	126	0
Prill	164	114	50
Maj	155	98	57
Qershor	86	116	-30
Korrik	139	82	57
Gusht	196	60	136
Shtator	126	233	-107
Tetor	130	354	-224
Nëntor	387	80	307
Dhjetor	63	65	-2
Totali:	1519	1478	41

Grafikoni - Paraqitje të reja të konsumatorëve gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2018



Gjatë muajit Mars 2018, edhe përkundër instalimit të ujëmatësve dhe regjistrimit të konsumatorëve (144) të rinjë në fshatin Guri i Kuq dhe Palluzhë, kemi bere largimin e tyre , ku ne muajin Nëntor 2018, kemi kthyer regjistrimin e tyre ne databazë.

Mirëmbajtja e rrjetit të Kanalizimit Fekalë dhe Atmosferik Gjakovë, Rahovec

Rrjeti i kanalizimit fekale për Gjakovë dhe Rahovec, përafërsisht është 80 km .Mbulushmeria me shërbime te kanalizimit është përafërsisht 85% për zonën e shërbimeve për ujera te zeza. Numri i ankesave për shërbime te kanalizimit ka qene xxxxxx për Gjakove, dhe janë trajtuar te gjitha me kohe.

Ekipi i mirëmbajtjes së kanalizimit ka berë mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit fekal dhe Atmosferik të qytetit në Gjakovë dhe në Rahovec.

Këtu përfshihet pastrimi i rrjetit, pusetave dhe ujë mbledhësve në njësit që menaxhohen nga ekipa e mirëmbajtjes së kanalizimit.

Tabela - Intervenimet në rrjetën e Kanalizimit Fekale gjatë periudhës Janar -Dhjetor 2018.

Vitet	Gjakovë 2018			Rahovec 2018			Gjakovë 2017			Rahovec 2017		
	Pastrimi rrjetit	Pastrimi i pusetave	Interv. me cistern	Pastrimi rrjetit	Pastrimi i pusetave	Interv. me cistern	Pastrimi rrjetit	Pastrimi i pusetave	Interv. me cistern	Pastrimi rrjetit	Pastrimi i pusetave	Interv. me cistern
Janar	7,360	158	45	670	5	12	6,915	135	73	1,530	10	20
Shkurt	7,335	143	36	1,208	32	13	6,980	162	60	1,435	17	30
Mars	8,167	187	58	2,635	30	38	5,180	125	57	1,020	62	26
Prill	6,396	128	41	1,890	43	22	7,390	185	56	1,835	81	32
Maj	6,055									1,900	20	25
Qershor	6,177	114	45	2,270	56	20	6,250	145	70	1,160	62	27
Korrik	5,265	145	48	2,940	112	35	5,080	137	66	3,135	15	24
Gusht	5,045	135	57	3,000	16	43	5,660	147	93	1,645	25	38
Shtator	5,280	137	39	1,469	69	26	6,770	196	55	1,155	18	19
Tetor	4,850	143	43	2,769	127	31	6,620	152	65	2,925	26	33
Nëntor	5,920	164	40	2,520	126	27	10,250	118	68	1,480	50	30
Dhjetor	5,995	136	30	1,050	44	16	6,795	171	55	2,055	63	6
Totali:	73,845	1,720	526	24,056	741	308	82,490	1,765	780	21,275	449	310

Ndryshimi në mes viteve 2018, krhasuar me vitin 2017, sipas aktiviteve

Gjakovë - Ndryshimi 2017/2016			Rahovec - Ndryshimi 2017/2016		
Pastrimi rrjetit	Pastrimi i pusetave	Interv. me cistern	Pastrimi rrjetit	Pastrimi i pusetave	Interv. me cistern
(445)	23	(28)	860	5	8
(355)	(19)	(24)	227	(15)	17
(2,987)	62	1	(1,615)	32	(12)
994	(57)	(15)	(55)	38	10
2,545	38	(18)	265	(61)	-
73	(31)	(25)	(1,110)	6	7
(185)	8	(18)	195	(97)	(11)
615	(12)	(36)	(1,355)	9	(5)
1,490	(59)	(16)	(314)	(51)	(7)
1,770	(9)	(22)	156	(101)	2
4,330	46	(28)	(1,040)	(76)	3
800	(35)	(25)	1,005	19	(10)
8,645	-45	-254	-2,781	-292	2

Planifikimet e Investimeve kapitale për ujërat e ndotura, janë planifikuar që të realizohen projektet në rehabilitimin e rrjetit, kolektorëve dhe ndërtimin e Impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura, me ndihmën e donatorëve; SECO, KFW, Komuna e Gjakovës, sipas fazave të planifikuara, me çmime të përafërta llogaritë me paramasa dhe parallogari:

Faza III

- Vazhdimi i ndërtimit të Kolektorëve kryesor (kolektori I & 2), 3,695,933.26 €
- Ndërtimi i Impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura 7,27 milion €

Faza V

- Inspektimi i rrjetit të kanalizimit me CCTV kamera 341.000€
- Rehabilitimi i gjetjeve pas Raportit të inspektimit të CCTV 1.470.000€

Faza VI

Është duke u diskutuar që Faza e VI e projektit të Eliminimit të Ujërave të Ndotura në Jugperëndim të Kosovës, të jetë vazhdimësi e fazës së V, pasi që fondet e ndara për fazën e V, nuk do të jenë të mjaftueshme për të arritur objektivat e synuara.

Zyra për Planifikim dhe Zhvillim gjatë vitit 2018, kanë hartuar këtë projekte ideore:

1. Renovimi i digës në Llukë të Epërme
2. Ekzekutimi i Rregullimit të kanalit derivues (Kanjoni) në fund të kanalit të mbyllur;
3. Ekzekutimi i kanalit të kapërderdhjes të ujit të Liqeni i Radoniqit (në digë);
4. Ndrimi i gypave të Azbest –Cimentos në qytetin e Gjakovës;
5. Ndrimin e gypave të Azbest-Cimentos në lagjet jashtë Gjakovës, Rahovec dhe fshatrat e Prizrenit;
6. Ndrimi i gypit Dobidol – Qifllak;
7. Ekzekutimi i bay-pasit të kanali derivues;
8. Projektet ideore për riparime në Guri i Kuq dhe Palluzhë;
9. Projekti për Gypësjellësin kryesor për furnizimin me ujë të pijës NJP "Lumbardhi" , KK Xerxe-Piran-Mamushë dhe KK Suharekë me fshatra;
10. Hartimi i projektit ideor "Furnizimi me ujë të pijës i fshatrave të Komunës së Malisheves"
11. Projekti: Ndrimi i gypit shtytës nga AC gypa në drejtim ST. P. "Sopot" rez. "Palabardh" dhe gypit furnizues për fsh. Janosh si dhe Ndërtesën administrative në Digë;
12. Projekti "Rehabilitimi i ndërtesës administrative në Prizren";
13. Projekti: Përfundimi i punimeve të ujësjellësit për 28 fshatra -Gjakovë;
14. Projekti: Projektimi i rrjetit për fsh. polluzh të Komuna e Rahovecit me ramje të lire – Gravitacion;
15. Projekti ideor për "Riasfaltimin e rrugës nga ndarja e fshatit Bec deri te Stacioni i Filtrimit"

Shërbimi Gjeodezik Janar-Dhjetor 2018

Shërbimi gjeodezik , ka qenë i angazhuar në inqizimin e havarive , lidheve të reja në tri njesite punuese në Gjakovë, Rahovec dhe Lumbardh. Veç kësaj ka kryer dhe punë të tjera sipas kërkesave nga udhëheqësit apo departamentet tjera, të cilat po i çekim me poshtë.

Të gjitha shënimet e terrenit pasi janë transferuar nga GPS_i në PC , janë përpunuar dhe bartë në softwerin e Gis_it MapInfo dhe Arcgis.Punë e veçantë është duke u bërë në bartjen e shënimeve të kanalizimit fekal dhe atmosferik nga MapInfo në Arcgis.Në fillim të vitit 2018, rrjeti i inqizuar në sistemin e GIS-it ka qenë; **741.280** km, ndërsa në fund të vitit 2018, kemi inqizim dhe rexhistrim të rrjetit në sistemin ARCGIS prej: **771.61 kilometra**

Tabela –Inqizimi i havarive ne teren dhe inqizimi i dislokimeve dhe instalimeve te reja ne teren në ujësjellës dhe kanalizim

Nr. rendor	Lokacioni	Përshkrimi i punës – Numri i iqizimeve 2018	Përshkrimi i punës – Numri i iqizimeve 2017
	Njësia punuese Gjakovë, Rahovec dhe Lumbardh	Numri i Inqizimeve të havarive, inqizimi i dislokimit te gypave dhe instalimi i gypav të rinj nga 1 coll deri Ø 1100	Numri i Inqizimeve të havarive, inqizimi i dislokimit te gypave dhe instalimi i gypav të rinj nga 1 coll deri Ø 1100
1.	A. Ujësjellësi:	Janar –Dhjetor 2018 Numri i Inqizimeve 637	Janar –Dhjetor 2017 Numri i Inqizimeve 273
2.	B. Kanalizimi	Janar –Dhjetor 2018 Numri i Inqizimeve 14	Janar –Dhjetor 2017 Numri i Inqizimeve 55

Detektimi Akustik i Rrjetit Janar-Dhjetor 2018

Njësia për detektim Akustik është duke u përdorur sipas nevojës në rastet e ndonjë dyshimi eventual për rrjedhje të ujit. Janë bërë detektime sipas kërkesave gjatë paraqitjes në zyrën e Departamentit Teknik, zyrën për marrëdhënje me konsumatorë, apo paraqitjes te zyrat e mirëmbajtjes se rrjetit, si në vijim:

Nr. rendor	Lokacioni	Përshkrimi i punës – Numri i detektimeve me aparat detektues	Përshkrimi i punës – Numri i detektimeve me aparat detektues
	Njësia punuese Gjakovë, Rahovec dhe Lumbardh	Inqizimi i detektimeve ne teren	Inqizimi i detektimeve ne teren
1	Detektimi i realizuar	Janar – Dhjetor 2018, 186 detektme te ndryshme	Janar – Dhjetor 2017, 320 detektme te ndryshme

Sektori për Mirëmbajtje Mekanike, Janar -Dhjetor 2018

Sektori për mirëmbajtje mekanike gjatë vitit 2018, ka realizuar këto aktivitete:

Furnizimi me derivate te naftes per automjetet e KRU "Gjakova" Sh.A. ne "Petrol Company", -Perpilimi dhe dorezimi i raporteve te menaxhimit dhe pranimit per:

- a) GPS-at e automjeteve te KRU Gjakova 1-12/2018
- b) furnizim me derivate te naftes 1-12/2018
- c) furnizim me autooma dhe bateri 1-12/2018
- d) servisimi i automjeteve te lehta-renda 1-12/2018

Gjatë vitit janë realizuar;

- kontrollimet dhe intervenimet e perditshme ne 35 stacionet e pompave dhe rezervareve akumulues;
- Servisimi i automjeteve zyrtare te KRU Gjakova, tek fituesi i tenderit "Mercedes Benz" Gjakove:

- Regjistrimi dhe ndërimi i tabelave të automjeteve të KRU Gjakova dhe për automjetet ushtarake të marrura nga aeroporti i Gjakoves, të dhënat teknike për secilin automjet i janë dërguar doganës dhe shpëdicionit. Pas një kohe personat e autorizuar të shpëdicionit dhe doganës kanë bërë verifikimin praktik të automjeteve dhe si përfundim kanë lëshuar dokumentin zyrtar doganor për vazhdimin e procedurës-shiqimi teknik dhe regjistrimi i automjeteve, pastaj janë servisuar këta automjete të marrura nga aeroporti i Gjakovës: kamioni për pastrimin e bores, mini busi, kamioni ushtarak dhe makina e dorës për pastrimin e stazave-pritet regjistrimi i tyre.

Sektori për Mirëmbajtje Elektrike – Janar -Dhjetor 2018

Sektori për mirëmbajtje elektrike gjatë vitit 2018, ka realizuar këto aktivitete:

- Leximin e njësorëve elektrik në të gjitha stacionet e pompave dhe objekteve të KRU Gjakova sh.a. dhe krahasimi i tyre me faturat e energjisë elektrike të KEDS.
- Kontrollimi dhe fotokopjimi i faturave të nergjisë elektrike 2018, për të gjitha objektet dhe stacionet e pompave dhe procedimi tutje.
- Përpilimi i bilancit elektronergjetik ,
- Testimi i matjeve elektroenergjetike në tërë zonën e shërbimit,
- Mirëmbajtja e trafave dhe substarterave në të gjitha stacionet e pompave dhe rregullimi i roleve elektrike në tërë zonën e shërbimit.

3.3 Ndryshimet që kanë ndodhur në performancë operative në krahasim me vitin e kaluar dhe me çaqet e planit të biznesit .Pse këto ndryshime kanë ndodhur

Pasqyra e performancës operative në krahasim me vitin Paraparak dhe planin e vitit aktual							
		2017	2018	Ndryshi	BP 2018	2018	Ndryshimi
1	Uji i prodhuar në m ³	14,981,6	14,992,45	+10,842	14,004,90	14,992,458	+987,556
2	Uji i faturuar në m ³	7,963,72	8,467,413	+503,682	7,562,647	8,467,413	+904,767
3	Humbja e ujit në %	47%	43.5%	-3.5	46%	43.5%	-2.5
4	Konsumatorë të regjistruar	35,887	37,406	+1,519	37,440	37,406	-34
5	Nr. I konsumatoreve me ujmatës	35,887	37,406	+1,519	37,440	37,406	-34
6	Kualiteti I ujit	100%	100%	0	100%	100%	0
7	Numri I punetoreve	260	265	+5	266	265	-1

PRODHIMI I UJIT- Prodhimi i ujit në vitin 2018 krahasuar me prodhimin e ujit gjatë vitit 2017, ka rezultuar me rritje prej **10,842 m³**, ndërsa krahasuar me BP ka gjithashtu rritje prej **987,556 m³**. Kjo rritje e prodhimit ka rezultuar me testimet e ujit në fabriken e re -faza 2, dhe testimit të ujit në fshatin Guri i kuq, Palluzh dhe Lubizhd e Hasit. Me këtë sasi kemi arritur të sigurojmë 24 ore ujë të pijes për konsumator, pastaj kemi bërë faturim me të lartë si dhe kemi zvogëlim të sasisë së humbjes së ujit të pijes.

FATURIMI m3- Në vitin 2018 faturimi në Euro është më i madh për 503,682 m³ se në vitin 2017, ndërsa krahasuar me BP 2018 ka rritje prej 904,767 m³. Në rritjen e faturimit ka ndikuar leximi i mirë i ujmatësve, puna e mirë e ekipit të kontrollës, eliminimi me kohë të defekteve nga departamenti teknik, puna e mirë e ekipit të detektimit të humbjeve.

NR. I KONSUMATORËVE-Në vitin 2018 krahasuar me numrin e konsumatorëve në vitin 2017 ka rezultuar me rritje prej 1,519 ndërsa krahasuar me BP 2018 numri i konsumatorëve ka rënie të vogël prej 34 konsumatorë. Arsyeja e rritjes së numrit të konsumatorëve ka qenë paraqitja e reja të rregullta nga konsumatorët kurse reja në krahasim me BP 2018 ka ndodhur nga një parashikim jo i sakt.

NR. I TESTEVE TE DESHTUARA-Përmirësimi i cilësisë së ujit të pijshëm, në laboratorët tona, si në atë për analizat fiziko- kimike dhe atë bakteriologjike, nga stafi i Sektorit të prodhimit të ujit në kontinuitet është bërë klorifikimi i ujit me sasinë e kërkuar sipas standardit të caktuar nga IKSHP-ja, janë marrë të gjitha aktivitetet që uji nga lumi Bistrica të futet në liqe me sasinë maksimale dhe të ketë kapërderdhje në sasinë e dëshiruar që ka mundur edhe të kemi ujë cilësor të pastër .

NR. I PUNËTORËVE -Në vitin 2018 krahasuar me Planin e Biznesit të vitit 2018 është më i vogël për -1 punëtorë, ndërsa krahasuar me vitin 2017 ka pas rritje për 5 punëtor . Kjo rritje ka ardhur si rezultat i ri-Organizimit dhe ri-Sistematizimit të punëve dhe detyrave të punëve në Kompani .

HUMBJET E UJIT -Në vitin 2018 humbjet e ujit janë 43.5% krahasuar me 2017 humbjet e ujit kanë rënie prej 3.5%, kurse me BP 2018 humbja ishte planifikuar të jetë 46%%, pra e kemi realizuar BP për 2.5%%. Menaxhmenti në vitin 2018 ka marrë detyrë që me aktivitetet e shtuara në terren nga ane kontrolles dhe ekipit të mirëmbajtjes të ulë humbjet sipas biznes planit.

3.4 PASQYRË E PËRFORMANCES FINANCIARE DHE REZULTATET

3.4.1 Ndryshimet në të hyrat dhe shpenzimet nga viti I kaluar dhe ndryshimet me caqet e Planit të Biznesit dhe Buxhetit

Tab. Ndryshimet në të hyrat dhe shpenzimet nga viti i kaluar dhe ndryshimet nga caqet e BP

Pasqyra e performances financiare në krahasim me vitin Paraprak dhe planin e vitit aktual							
		2017	2018	Ndryshimi	BP 2018	2018	Ndryshimi
1	Tëhyratngashitjaeujit	4,034,672	4,341,934	+307,262	3,999,955	4,341,934	+341,979
2	Tëhyrattjera	276,728	370,098	+93,369	72,000	370,098	+298,098
	TOTALI						
	Shpenzimetoperative						
1	Shpenzimet e pagave	2,111,232	2,122,386	+11,154	2,225,174	2,122,386	-102,788
2	Shpenzimet e riparimeve	112,752	81,924	-30,827	78,128	81,924	+3,796
3	Shpenzimet administrative	30,200	31,952	+1,751	30,000	31,952	+1,952
4	Shpenzimet e energjisë elektrike	283,693	267,183	-16,509	273,731	267,183	-6,548
5	Shpenzimet e derivateve	72,260	81,146	+8,886	81,080	81,146	+66
6	Shpenzimet e kemikaljeve	28,580	35,325	+6,744	102,300	35,325	-66,975
7	Shpenzimet e marketingut	20,970	27,626	+6,656	20,000	27,626	+7,626
8	Shpenzimet tjera operative	274,807	506,595	+231,787	247,953	506,595	+258,642
	TOTALI	2,934,497	3,154,141	+219,643	3,058,366	3,154,141	+95,775

TË ARDHURAT - Gjatë vitit 2018 me të ardhurat e realizuara KRU-ja ka mbuluar 100% të kostos së operimit të mirëmbajtjes. Krahësuar me të hyrat nga uji të vitit aktual me vitin paraprak të ardhurat janë për 307,262 € më shumë, ndërsa me BP janë për 341,979€ më shumë.

SHPENZIMET OPERATIVE- Gjatë vitit 2018 shpenzimet operative janë për 95,775 € më të larta se me BP 2018, ndërsa nëse krahasojmë me vitin 2017 shpenzimet operative kanë pësuar rritje prej 219,643 €. Këto shpenzime si të tilla gjatë vitit mundësuan përmbushjen e obligimeve dhe zhvillimin normal të Kompanisë.

3.4.2 Ndryshimet në të ardhura dhe shpenzime –faktorët ndryshues në këto ndryshime

Faktorët ndikues në rritjen e të ardhurave

Në KRU "Gjakova" në ndryshimet në të ardhura gjatë vitit 2018 kanë ndikuar këta faktorë: Ristrukturimi Organizativ (formimi i Nj. për detektimin e humbjeve të ujit, plotësimi me personel i grupeve të Çkyçjes dhe Kontrollës si dhe veprimi i tyre me kohë dhe në mënyrë kualitative), bashkëpunimi me institucionet dhe gjykatat, zvogëlimi i konsumatorëve paushall, ekzekutimi dënimeve administrativ nga kompania ndaj konsumatorëve keq përdorues, sanimi me kohë i defekteve në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, investimet në shtrirjen e rrjetave të reja të ujësjellësit, pranimi i projekteve të reja të furnizimit me ujë të komuniteteve që kanë mundësuar edhe rritjen e numrit të konsumatorëve, inkasimi përmes Përmbaruesve Privat i borxheve të konsumatorëve persona juridik dhe fizik etj.

Faktorët ndikues në rritjen e shpenzimeve

Janë: Ndërtimi me mjete vetanake të infrastrukturës ujore, infrastrukturës rrugore, ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës së objekteve të kompanisë, sanimet e rrjetit të ujësjellësit, funksionimin e SF dhe kontrollin e cilësisë së ujit të pijes, kërkesat për realizimin e veprimtarisë administrative në kompani (shpenzimet e personelit për paga dhe mëditjet, shpenzimet e energjisë elektrike, shpenzimet e derivateve, shpenzimet e kemikaleve (përfshin aluminsulfatin, klori i gaztë, klor i lëngët, kloruri i hekurit dhe karboni aktiv), si dhe shpenzimet tjera (përfshin shpenzimet administrative, regjistrimi dhe siguri i automjeteve, taksat për licencim të shërbimeve ARRU, taksa e SHUKOS-it, taksa për shfrytëzimin e ujit MMPH, shërbimet nga palët e treta), etj.

Shpenzimet e pagave

Në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 shpenzimet kanë pësuar rritje të lehtë prej 11,154 €, ndërsa me BP 2018 kanë rënë për 102,788€. Në këto shpenzime hyjnë: pagat, mëditjet, bonuset, trajnimet. Janë më të larta se në vitin 2017 ngase është rritur edhe numri i punëtorëve, pasi disa grupe të punëtorëve paguhen sipas realizimit dhe rritja e arkëtimit ndikon direkt në rritjen e vlerës së pagave, pagesa për punën shtesë.

Shpenzimet e riparimeve

Përfshin pjesët e vogla për riparim, mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, mirëmbajtja e automjeteve etj. Ka rritje krahasuar me BP sepse Kompania ka arritur që me mjetet e veta vetanake dhe nga donacionet të bëjë zëvendësimin e makinerive të vjetra me të reja. Shpenzimet e riparimeve për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 kanë pas rënë për 30,827€. Ndryshimi Shpenzimeve të riparimeve për vitin 2018 krahasuar me BP 2018 kanë qenë 3,796-€ më shumë.

Shpenzimet administrative

Përfshijnë shpenzimet administrative të gjërave si: Letra, ngjyrë printeri, telefonat, etj. Shpenzimet administrative për vitin 2018 krahasuar me 2017 kanë pas rritje për 1,751€. Shpenzimet adm. për vitin 2018 krahasuar me BP 2018 kanë pas rritje për 1,952€.

Shpenzimet e derivateve

Kur krahasojmë me vitin 2017 shpenzime të derivateve janë më të larta për 8,886 euro, kurse kur krahasojmë me BP 2018 janë më të larta për 66 euro. Shpenzimet e derivateve janë rrit nga

rritja e aktivitetit në teren të ekipeve të çkyqjes, kontrolles, mirëmbajtjes etj.

Shpenzimet e rrymës elektrike

Këto shpenzime krahasuar me BP 2018 si dhe shpenzimet e vitit 2017 kanë qenë më të ulëta. Shpenzimet e rrymës elektrike për vitin 2018 krahasuar me 2017 kanë pas rënie për 16,509 €. Shpenzimet e rrymës elektrike për vitin 2018 krahasuar me BP 2018 kanë gjithashtu rënie prej 6,548 €.

Shpenzimet e kemikaljeve

Përfshijnë alumin sulfatin, klori i gazet, klor i lënget, kloruri i hekurit dhe karboni aktiv .Krahasuar me vitin 2017 gjatë vitit 2018 shpenzimet e kemikaleve kanë pas rritje për 6,744 €,ndërsa krahasuar me BP 2018 shpenzimet e kemikaleve kanë pasë rënie për 66,975 €.

Shpenzimet e marketingut

Përfshijnë shpenzimet për reklama, kontratat me mediat . Shpenzimet e marketingut për vitin 2018 krahasuar me 2017 kanë pas rritje prej 6,565€, ndërsa krahasuar me BP 2018 e vitit 2017 kanë pas rritje për 7,626€.

Shpenzimet tjera operative

Përfshin shpenzimet administrative, regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve,taksat për licencim të shërbimeve ZRRUM, taksa e SHUKOS-it, taksa për shfrytëzimin e ujit MMPH, shërbimet nga palët e treta. Shpenzimet tjera Operative për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 kane pasur rritje prej 219,643 euro, kurse kur krahasojmë me BP 2018 kane pasur rritje prej 95,775 euro. Shpenzimet tjera kanë ngritje pasi Kompania në vitin 2018 ka filluar ti paguaj shpenzimet vetnake te ujit dhe te njëjtën kohe ato regjistrohen si shpenzim, vlers totale është 168,466 euro.

Përkundër shpenzimeve të cekura Kompania gjatë vitit 2018 ka operuar me fitim operativ ku nga Arkëtimi 4,267,046 euro zbriten Shpenzimet Operative ne shume prej 3,154,141 euro, Fitimi Operativ ka vlerën 1,112,905 Euro.

3.4.3 Komentet mbi ndryshimet ne strukturën e kapitalit ,duke përfshi huat apo ndonjë formë tjetër te financimit

Kompania gjatë vitit 2018 ka pësuar ndryshime në strukturën e kapitalit pasi qe është hera e dyt që Kompania operon me fitim financiar. Fitimi financiar për vitin 2018 është 126,918 euro, kurse në vitin 2017 ka qenë 13,498 euro, pra për 113,420 euro më i lart se viti 2017.

3.5 PROGRESI ME PLANIN E BIZNESIT

3.5.1 Pasqyrat e progresit ne implementimin e Planit të Biznesit

Tabela- Pasqyra e performances operative dhe financiare në krahasim me BP

Treguesit kryesor te performances		Caqet e planifikuara BP 2018	Caqet e realizuara 2018	Ndryshimi
1.	Uji i prodhuar në m ³	14,004,902	14,992,458	+987,556
2.	Uji I faturuar në m ³	7,562,647	8,467,413	+904,767
3.	Konsumatorë të regjistruar	37,440	37,406	-34
4.	Nr. I faturave të lëshuara	37,440	37,406	-34
5.	Nr. I kons. që faturohen sipas leximit të	36,961	36,969	+8

6.	Ujii faturuar për kons. me ujmatësa	7,033,262	8,112,059	+1,078,797
7.	Faturimi në €	3,999,955	4,431,934	+431,979
8.	Arketimi në €	3,523,281	4,196,351	+673,070
9.	Te hyrat tjera operative ne €	60,000	70,695	+10,695
10.	Shpenzimet operative	3,058,366	3,154,141	+95,775
11.	Shlyerja e borxheve ndaj kons.	0	0	
12.	Shlyerja e obligimeve nga kreditorët	0	0	
13.	Parat e gatshme në bankë dhe në arkë	511,169	293,609	-217,560
14.	Stoqet	552,375	604,966	+52,591
15.	Llogarit e arketueshme €	6,340,940	11,025,209	+4,684,269
16.	Llogarit e pagueshme	6,853,940	11,723,930	+4,869,990
17.	Numri i punetoreve	266	265	-1
18.	Numri i ankesave	600	870	+270
19.	Numri total i testeve të realizuara	1,335	2,816	+1,481
21.	Matja e treguesve ne %			
22.	Uji i pa faturuar	46%	43.5%	-2.5%
23.	Përqindja e faturimit	99%	100%	+1%
24.	Përqindja e konsumit të matur	93%	96%	+3%
25.	Proporcioni i kons. Me ujmatësa	98%	99%	+1%
26.	Efikasiteti i stafit	7.10	7.08	-0.02%
27.	Shkalla e inkasimit në % (të tërë)	88%	97%	+9%
28.	Shkalla e inkasimit në % - amvisni	81%	92%	+11%
29.	Shkalla e inkasimit në % - biznese	87%	111%	+24%
30.	Shkalla e inkasimit në % - industri	99%	107%	+8%
31.	Norma e mbuleses së punes	1.17	1.35	-0.18
32.	Norma e punes	1.33	1.40	+0.07
33.	Shpenzimet Operativ per konsumator	6.81	7.03	+0.22

Uji i prodhuar në m³- Prodhimi i ujit në vitin 2018 krahasuar me BP ka rritje prej **987,556 m³**. Ky rritje i prodhimit ka ardhur si rezultat i rritjes se kërkeses së ujit, çka tregon një sukses sepse me këtë sasi kemi arritur te sigurojmë 24 ore ujë te pijes për konsumator, pastaj kemi bere faturim me te larte si dhe kemi zvogëlim te sasisë se humbjes se ujit te pijes.

Uji i faturuar në m³- Në vitin 2018 kur krahasojmë me BP 2018 ka rritje në vlerë prej 904,767 m³. Në rritjen e Faturimit ka ndikuar leximi me i mir i ujmatesve, ekipa e teknikes ne eliminimin e defekte ne kohe, puna e mir e kontrolles, puna e mir e ekipit te detektimit.

Numri i ankesave- Kur krahasojme vitin 2018 me BP e vitit 2018 numri i ankesave ka rritje për 205, pasi nuk kemi bere parashikim te sakt dhe rritja e vetëdijes se konsumatorit vjen deri te ritja e ankesave.

Numrin e konsumatorëve – Krahasuar me BP e vitit 2018 numri total i konsumatorëve ka zvogëlim prej 34 konsumatorësh .

Arketimi - në Euro në vitin 2018 krahasuar me Planin e Biznesit të vitit 2018 arketimi nga uji ka --rritje prej 673,070 euro kurse nga arketimet tjera ka prej prej 10,965 euro, ne total arkëtimi ka --rritje prej 683,765 euro. Pëveq në euro edhe në% ka rritje të faturimi. Vitin 2018 e kemi mbyllur me 97% të shkallës së arkëtimit. Sfid mbetet që këtë shkall ta mbajm edhe në vitin 2019.

Humbjet e ujit - në përqindje në vitin 2018 krahasuar me Planin e Biznesit të vitit 2018 kemi të --rënie prej 2.5%.

Shlyerja e obligimeve nga kreditorët –Kompania në përgjithësi e ka arritur planin e shlyerjes së obligimeve ndaj furnitorëve si rezultat i rritjes se te hyrave te realizueshme gjatë vitit 2018 .**Parat e gatshme në bankë dhe në arkë** - Kompania gjatë vitit 2018 e ka mbyllur me 293,609- euro, kur

krahasojme me BP 2018 kemi zvogëlim prej 217,560 euro, pasi në vitin 2018 kemi paguar firmën PEVLAK-u per ndërtimin e fabrikës se re te ujit.

Shpenzimet operative - Gjatë vitit 2018 shpenzimet operative janë për 95,775€ më larta- se me BP 2018. Këto shpenzime si të tilla gjatë vitit mundësuan përmbushjen e obligimeve dhe zhvillimin normal te Kompanisë.

Numri i punëtorëve – Në vitin 2018 krahasuar me Planin e Biznesit të vitit 2018 është më i ulët për 1 punëtor punëtorë, ndërsa krahasuar me vitin 2017 ka pas rritje për 5 punëtor . Kjo rritje ka ardh si rrezultat i ri-Organizimit dhe ri-Sistematizimit të punëve dhe detyrave të punëve në Kompani .Që të kemi avancimin e këtyre treguesve kryesor të performances në të ardhmen ; Faturimit ,Inkasimit si dhe Humbjeve të ujit do të arrihet përmes realizimit të projekteve, ku me theks të veçantë mund të përmendim; Hapja e portoarkave në disa lagje me dendësi më të madhe të konsumatorëve ku kompania fillon të zbaton një politik që inkasantët dal ngadalë ti largon nga tereni dhe të ndërpres pagesën në kesh në dorë, si dhe çkyqje konsumatorëve borxhlinj nga rrjeti i ujesjellesit . Matjet komerciale përmes leximit të të dhënave komulative të ujëmatësve kryesor dhe shtëpiak në mënyrën elektronike përmes datalogerëve ;identifikimi I humbjeve administrative dhe komerciale të ujit ; si dhe bashkëpunimi I drejtpërdrejtë dhe permanent I institucioneve të pushtetit lokal të Komunave të cilat operon Kompania .

Në avansimin kryerja e obligimeve me kohë ndaj konsumatorëve

Falë angazhimit profesional Kompania ka vazhduar të dëshmoi përpikëri në zbatimin e standardeve më të larta profesionale në raport me konsumatorin .Ka vazhduar të modifohet hapësira për ofrimin e shërbimeve për konsumator, me standarde te mjaftueshme qe konsumatorëve të ju mundësohet qasje e lehtë në realizimin e kërkesave te tyre, dhe kryerjen e obligimeve ndaj Kompanisë. Këtë drejtim është realizuar projekti mbi Ndërrimin e ujëmatësve kryesor dhe individual, Kontrollimit, identifikimit dhe evitimit/pengimit të parregullsive/ keqpërdorimeve në shfrytëzimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit të ujërave të zeza. Ndërtimi i rezervarëve dhe rrjetit të ujësjellësit për furnizimin me ujë të pijes ,hapja e numrit të madh të portoarkave ku me këtë planifikim po ju mundësohet konsumatorëve një shërbim me i afërt dhe cilësor i pagesave si dhe për kompaninë po arrihet heqja e keshit nga inkasantet .

Përkujdesja për sigurimin e punëtorëve dhe objekteve

Në harmoni me objektivin e përgjegjshmërisë në aspektin social Kompania ka ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë për punëtorët e saj ,duke i siguruar kushtet e mira të punës në bazë standardeve më të larta .Po përmendim këtu; Realizimi i Programit të sigurimit të veshmbathjeve të punëtorëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë.Edhe për vitin 2018 është planifikuar që punëtorët të furnizohen me të gjitha mjetet e mbrojtjes në punë si dhe është realizuar në tërësi procedura e prokurimit për sigurimin me kohë të tyre .

Kompania ka investuar në zhvillimin profesional të punëtorëve në realizimin e trajnimeve ,pjesëmarrjen ne seminare ,workshope dhe grupe punuese. Janë realizuar blerje të pajisje kompjuterike për zyrë dhe punë në teren .

3.5.2 Përmbledhje e progresit te objektivave kryesore dhe strategjike

Nga treguesit e arritur të performances të vitit 2018 ,konkludojmë se kompania gjatë vitit 2018 ka arritur që të ketë performancë pozitive krahasuar me vitin paraprak 2017 në disa treguesit e performances .

Realizimi I parametrave oscilon 98% e që kjo ka ndodh që mos të realizojmë 100% të treguesve vetëm për shkak se në një masë të vogël ka ardh deri te rritja e shpenzimeve për arsyt e domosdoshme të realizimit të objektivit për implementimin e projekteve që do mundësojnë

mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit dhe shtrirjen e rrjetave të reja, si dhe përmirësimin e mirëqenies së punëtorëve dhe infrastrukturës ujore në Kompani.

Treguesit	2017	2018	Ndryshimet	BP 2018	2018	Ndryshimet
Prodhim i m³	14,981,619	14,992,458	+10,842	14,004,902	14,992,458	+987,556
Faturimi m³	7,963,721	8,467,413	+503,682	7,562,647	8,467,413	+904,767
Humbja ujit %	47%	43.5%	-4%	46%	43.5%	-2.5%
Faturimi €	4,034,672	4,431,934	+307,262	3,999,955	4,431,934	+431,979
Arkëtimi €	3,512,467	4,196,351	+683,883	3,523,281	4,196,351	+673,070
Arkëtimet tjera €	77,928	70,695	-7,232	60,000	70,695	+10,695
Arkëtimi %	87%	97%	+10%	88%	97%	+9%
Shpenzimet €	2,934,497	3,154,141	+219,644	3,058,366	3,154,141	+95,775
Fitimi operativ	+655,898	+1,112,905	+457,007	+524,915	+1,112,905	+587,990

Prodhim i ujit në m³ Prodhim i ujit në vitin 2018, krahasuar me prodhimin e ujit gjatë vitit 2017 ka rezultuar me një rritje të vogël prej; 10,842 m³, ndërsa krahasuar me BP ka gjithashtu një rritje prej; **987,556 m³**. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i terstimt të fazes së dytë dhe testimit të dy fshatrave Paluzh dhe Guri i Kuq. Falë kapaciteteve të prodhimit, kemi arritur të sigurojmë 24 orë ujë të pijes për konsumator, pastaj kemi bërë faturim me të lartë si dhe kemi zvogëlim të sasisë së humbjes së ujit të pijes për 3.5 % brenda vitit.

Faturimi – Në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, vlera e arkëtimt nga uji në Euro ka qenë për **683,883** euro me shumë, ndërsa për **673,070** më shumë se BP 2018. Faturimi në eruo ka ngritje, pasi ka ngritje edhe në m³.

Arkëtimi në Euro dhe në % – Krahasuar me 2017 vlera e arkëtimt në euro ka qenë me e madhe për 683,883€ ,ndërsa me përqindje ka rezultuar me një 97% ,ndërsa krahasuar me arkëtimi gjatë vitit 2018 në Euro ka qenë për 673,070€ më shumë ,ndërsa në përqindje ka qenë për 9% më shumë me BP 2018. Rritja më e madhe e arkëtimt duke krahasuar me vitin 2017 ka ndodhur pasi në vitin 2018 ka pasur sukses arkëtim më të madh nga Përmbaruesit Privat sidomos tek institucionet arkëtimi nga ky autoritet ka përfshirë **205,706.51 euro** .

Shpenzimet Operative - Gjatë vitit 2018 shpenzimet operative janë për 95,775€ më të lart se me BP 2018, ndërsa nëse krahasojmë me vitin 2017 shpenzimet operative kanë pësuar rritje prej 219,644€. Shpenzimet operative janë më larta se viti 2017 dhe BP i vitit 2018 ,arsyeja e kësaj rritje është ; bashkëfinancimi nga buxheti i Kompanisë në realizimin e Projekteve të mëdha të cekura në këtë raport ,ndërtimi me mjete vetanake të infrastrukturës ujore , infrastrukturës rrugore , ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës së objekteve të kompanisë,dukurit tjera që paraqiten në veprimtarinë e Kompanisë e sidomos ; Rritjes së inflacionit, rritjes së vazhdueshme të çmimit të energjisë elektrike, kemikateve, karburanteve të naftës, mirëmbajtja e pajisjeve dhe rrjetës. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përfshijnë shpenzimet e personelit (përfshin pagat, mëditjet, bonuset, trajnimet), shpenzimet e mirë mbajtjes dhe riparimeve (përfshin pjesët e vogla për riparim, mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, mirëmbajtja e automjeteve etj), shpenzimet e energjisë elektrike, shpenzimet e derivateve (përfshin naftën dhe benzinës për Kompaninë), shpenzimet e kemikaleve (përfshin alumin sulfatin, klor i gazet, klor i lënget, kloruri i hekurit dhe karboni aktiv), si dhe shpenzimet tjera (përfshin shpenzimet administrative, regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve, taksat për licencim të shërbimeve ZRRUM, taksa e ShUKOS-it, taksa për shfrytëzimin e ujit MMPH, shërbimet nga palët e treta), si dhe shpenzimet e ujit pasi Kompania ka paguar shpenzimet vetanake të ujit dhe kompensimet regjistruhen si të hyra ashtu edhe shpenzime.

Humbjet e ujit në %- Në vitin 2018 humbjet e ujit jone 43.5 % janë 4% më të ulëta se në vitin 2018,

kurse me BP 2018 humbja ishte planifikuar te jete 46%%, pra e kemi realizuar BP për 2.5%. Menaxhmenti në vitin 2019 ka marre detyre që me aktivitetet e shtuara ne teren nga ane kontrolles dhe ekipit te mirembajtjes te ule humbjet sipas biznes planit.

Fitimi operativ – Krahasuar me 2017 Fitimi Operativ në euro ka qenë më i lartë për 457,007 €, ndërsa krahasuar me BP 2018 fitimi operativ gjatë vitit 2018 në Euro ka rezultuar gjithashtu me i lartë për 587,990 €.

3.5.3 Çfarë ndryshime janë paraqitur gjatë aktiviteteve ,operimeve dhe ambientit të cilën e rrethon ndërmarrjen që nga përgatitja e planit të biznesit .Si do të ndikojnë këto ndryshime (nëse ka) në arritjen e objektivave të planit të biznesit

Gjatë aktiviteteve ,operimeve menaxhmenti I Kompanisë synon të realizon objektivat e Planit të Biznesit si dhe të përmirësoi edhe më tej performancën e Kompanisë në rritjen e të hyrave të Kompanisë si bazë themelore e krijimit të mundësive financiare të vetë ekzistimit dhe të investimeve kapitale përmes mjeteve vetanake. Në këtë rrugëtim gjatë aktiviteteve drejt realizimit të PB janë paraqitur disa ndryshime , si ; Është paraqitur nevoja qe përsëri te vazhdoje me hapjen e portoarkave në disa lagje me dendësi më të madhe të konsumatorëve;Funksionimin e detektorëve si dhe trajnimi I stafit në këtë drejtim për aftësimin e tyre në përdorimin e aparaturës (detektorëve) si dhe përdorimi i të njëjtave në teren; Matjet komerciale përmes leximit të të dhënave komulative të ujëmatësve kryesor dhe shtëpiak në mënyrën elektronike përmes datalogerëve ; Përmes organizimit të ekipeve shitesë është arritur të bëhet identifikimi I humbjeve administrative dhe komerciale të ujit ; si dhe bashkëpunimi I drejtpërdrejtë dhe permanent I institucioneve të pushtetit lokal të Komunave të cilat operon Kompania .

Me këto aktivitete është arritur që Kompania me mjete vetanake të siguroi që të ketë ndryshime në realizimin e Planit të Biznesit në ambientin që rrethon Kompaninë edhe në përmirësimin e kushteve të punës për punëtorët në kompani . Është arritur plotësimi i kushteve të punëtorëve realizuar një hapësirë më e madhe e punës një pastërti dhe komoditet në është arritur një efikasitet më i madh i punës si në aspektin kualitativ dhe kuantitativ si dhe kushte më të mira të punës realizimin e një hapësire më të madhe të punës për punëtorët si dhe është ofruar një përkujdesje dhe ndihmë në drejtim të realizimit të sigurimit shëndetësor

3.6. SHPENZIMET KAPITALE DHE TË PROJEKTEVE

Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2018

KRU "Gjakova " Sh.A. gjatë vitit 2018 ka bërë investime të shumta bazuar në planin e tij zhvillimor. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2018 janë realizuar me rregull dhe sipas afateve siç janë përcaktuar në Planin e Biznesit dhe në planin individual të Sektorit për Zhvillim dhe Projekte investive. Më poshtë janë përmendur projektet investive dhe burimet e financimit të projekteve në mënyrë të përgjithësuar, ndërsa statusi i tyre dhe detajet janë pjesë e këtij raporti. Gjatë vitit 2018 Kompania ka investuar në projektet e paraqitura në vijim nga mjetet e realizuara nga; donatorët, mjetet vetanake, dhe nga donacionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës;

Me investimet nga Donacionet është bërë realizimi i projekteve:

Investimet nga donacionet e KFW, Qeverisë ,CDI ,Komunave dhe vetanake për vitin 2018

- **Lot 1:** Linja e ujit te pijes nga baseni i Radoniqit, linja e Anadrinit , linjat dhe infrastruktura mbështetëse, Faza e dytë. *Totali i donacionit* - Për 2018: **685,997.83 €**.
- Projekti LOTI 2 "Linja e unit te pijes nga baseni i Radoniqit, linja e Anadrinit , linjat dhe infrastruktura mbështetëse, Faza e dytë. *Totali i donacionit* - Për 2018: **764,020.56 €**.
- Projekti LOTI 3 Kanali Derivues i Bazenit të Radonqit, Linja dhe Infrastruktura Mbështetëse është financuar nga MZHE në Totalin e Donacionit -Për 2018 :**316,550.19€**
- Eleminimi i ujërave të ndotura në JP të Kosovës faza III, "Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Gjakovë, tenderi nr. **KFW/BMZ201365501/** Gjakovë PH - III / WC-1", ndërrimi i kolektoreve 1& 2, vlera e kontrates baze: 3,695,933.26, pagesa per vitin 2018 nga KFW : **1,297,867.13 €**
- Rehabilitimi i sistemeve rurale të ujësjellësit në zonën e shërbimit të KRU " Gjakovë " Sh.A Gjakovë, për të gjitha fshatrat te investuara nga CDI Lot 1.
- Ndërrimi i gypit shtytës te Stacioni i pompimit në Bregdri dhe paisjeve përcjellëse në rezervuar dhe ndërtimi i stacionit të pompimit me rezervuar në Palluzhë për KRU "Gjakova" SH.A. Gjakovë me nr. të prokurimit KRURGJA-18-4391-5-2-1& KRURGJA-18-015-5-2-1, në vlerën prej : **128.852,55 €** me TVSH, pjesa e participimit të Komunës së Rahovecit është prej 49% të vlerës së projektit (Pjesa e Polluzhës) nga punët e kryera **27.739,64 €**, pjesa e participimit KRU "Gjakova" është 51% **101.112.91€**.

TOTALI: për 2018 :3,064,435.71 €.

3.6.1 Lista e investimeve kapitale

Gjatë vitit 2018 në KRU"Gjakova" janë bërë investime të konsiderueshme në rrjetin e ujësjellësit në Gjakovë dhe dy Njësit tjera në Rahovec dhe Prizren, si nga ana e Kompanisë ashtu edhe nga ana e Komunave .Në kuadër të përmirësimit të furnizimit të qytetarëve me ujë ,rritjes së konsumatorëve ,zhvillimit të infrastrukturës ujore ,kanalizimit ,te infrastrukturës së objekteve ,mirëqenies së punëtorëve etj. Kompania ka bërë disa investime në rrjetin e ujësjellësit sidomos në zgjerimin e zonës së shërbimit dhe në rritjen e presionit në rrjetin e ujësjellësit . Në vazhdim po paraqesim investimet e realizuara nga ana e Kompanisë që kanë të bëjnë me implementimin e projekteve :

Tabela - Lista e investimeve kapitale -2018

Lista – BIMËT SHUMËVJEQARE DHE SHKURRET	Vlera €
Furnizimim me bime dekoratve per stacionin e filtrave	48,206
TOTALI - BIMËT SHUMËVJEQARE DHE SHKURRET	48,206
Lista – OBJEKTET NDERTIMORE	
Investimet ne Objektiv Administrativ ne Dig	437,585
Investime te ndryshme ne Objekte	11,685
TOTALI OBJEKTET NDERTIMORE	449,270

Lista – RRJETI I UJËSJELLËSIT	
Investime ne Rrjetin e Ujesjellesit	527,583
TOTALI I RRJETIT TE UJSJELLESIT	527,583
Lista – UJMATESIT	
Instalimi i ujematesve tek konsumatorët e ndryshëm	58,085
TOTALI UJMATESIT	58,085
Investimet ne projekte te ndryshme	762.71
Totali- Investimet ne projekte te ndryshme	762.71
Investime ne rrjetin e kanalizimit	
Investime ne rrjetin e kanalizimit	2,474
TOTALI I INVESTIME NE KANALIZIM	2,474
Lista - Pajisje elektro mekanike	
Furnizim me material elektro-energjetik	13,123
Furnizim me 2 pompa dhe aparatur klorifikimi	3,500
Furnizim i punetoreve me mjetet e punës	8,259
Investim ne stacionin e pompave Opterush	10,145
Gjenerator donacion nga Aeroporti i Gjakoves	142,678
Paisjet tjera elektro mekanike	78,096
TOTALI PAISJET ELEKTRO MEKANIKE	255,800
Lista –Automjetet dhe Kamionat	
Donacion nga Aeroporti i Gjakoves	536,590
Furnizim me automjet Pick-Up Citroen	4,800
Furnizim me automjet Kombi udhetaresh	4,800
TOTALI Automjetet dhe Kamionat	549,891
Lista - Paisjet IT	
Paisje te ndryshme IT	15,056
TOTALI I PAISJEVE IT	15,056
Lista - MOBILJE DHE PAISJE PËR ZYRE	
Pajisje për zyre	1,676
TOTALI I MOBILJEVE DHE PAISJEVE PËR ZYRE	1,676
Investimet ne fazën e dyt te përpunimit te ujit	5,956,901
TTOTALI I INVESTIMEVE 2017	7,865,706

3.6.2 Komentet në progresin e projekteve kapitale të ndërmarrjes ,duke përfshi; Komete dhe vonesa administrative ,vonesa në prokurim,apo ndonjë ndryshim i kostove ne implementimin e projekteve .

Në realizimin e projekteve kapitale gjatë vitit 2018 Ndërmarrja ka treguar një progres të dukshëm. Projektet e planifikuara për vitin 2018 themi se pothuajse në tërësi janë realizuar ku në këtë realizim ka ndikuar rritja e të hyrave si rezultat i rritjes së arkëtimit si dhe të hyrave tjera . Projektet kapitale janë implementuar një pjesë nga mjetet tona vetanake , Grandet e aksionarit –Qeverisë së Kosovës, CDI, si dhe komunat e Regjionit qe furnizon Kompania .Sa i përket procedurës së implementimit (vonesa administrative ,vonesa në prokurim apo ndonjë ndryshim tjetër i kostove gjatë vitit 2018 mund të themi se të gjitha projektet janë realizuar pa ndonjë ngecje të qenësishme që do të pengonte realizimin e këtyre projekteve kapitale . Projektet e investuara nga mjetet donacionet e Qeverisë së Kosovës – mund të themi se procedurat administrative dhe të prokurimit si dhe kostove të shpenzimeve janë realizuar në

tërësi . Falënderuar stafit të prokurimit KRU-ja ka arritur që për vitin 2018 ti realizoi 100% të mjeteve nga donacionet e ndara për Kompaninë .

3.7 PRESPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHEM

3.7.1 Te paraqitet një skicë gjithëpërfshirëse e planit të biznesit për vitin e ardhshëm dhe të identifikohen objektivat kryesore;

Plani i Biznesit 2019-2021 definon çart orientimet zhvillimore të Kompanisë dhe definon çartë objektivat dhe rezultatet e pritshme duke marrë për bazë edhe rezultatet e arritura në periudhën paraprake .Plani është përgatitur duke pas parasysh gjendjen ekzistuese të Kompanisë ,trendët e zhvillimit të sektorit të ujit në Kosovë për të adaptuar praktikën më të mira të njohura për një zhvillim të qëndrueshëm të Kompanisë .

Por gjithashtu është marrë për bazë edhe ambienti ekonomik dhe social në regjionin tonë .

Plani i Biznesit 2019-2021, definon rrugën e zhvillimit të Kompanisë duke marrë parasysh përparësitë dhe rreziqet për realizimin e suksesshëm që do të rezultojnë me një arritje të vet qëndrueshmërisë financiare të Kompanisë .Parametrat operativ dhe financiar janë analizuar në mënyrë që të jenë të arritshme duke lënë mundësinë e tejkalimit të tyre –uljen e tyre pa e dëmtuar funksionimin dhe ofrimin sa më cilësor të shërbimeve ndaj konsumatorëve ,të jenë sa më lartë realitetit dhe parametrave të arritshëm.

Plani është i orientuar fuqishëm në drejtim të mundësive vetanake financiare dhe të donatorëve ku realizim i këtij plani e sidomos planit të investimeve është i varur edhe nga përkrahja që do të sigurohet nga donatorët ,institucionet qendrore dhe lokale .

Bordi i Drejtorëve ,Menaxhmenti si dhe të gjithë të punësuarit do të jenë të angazhuar maksimalisht që me punën e tyre të realizojnë objektivat që dalin nga ky plan , në mënyrë që Kompania të arrijë një qëndrueshmëri financiare që të ofrojë shërbime cilësore për konsumatorët. Në vazhdim po i paraqesim në formë tabelore treguesit kryesor operativ dhe financiar të performancës .

Treguesit kryesor të performancës		Caqet e realizuara 2017	Caqet e relizuara 2018	Caqet e planifikuara BP 2019
1	Uji i prodhuar në m3	14,981,619	14,992,458	15,758,606
2	Uji i faturuar në m3	7,963,721	8,467,413	8,959,303
3	Konsumatorë të regjistruar	35,887	37,406	42,106
4	Nr. I faturave të lëshuara	35,887	37,406	42,106
5	Nr. I kons. që faturohen sipas leximit të	35,316	36,969	41,685
6	Uji i faturuar për kons. me ujëmatës	7,439,297	8,112,059	8,332,152
7	Faturimi në Euro	4,034,672	4,431,934	4,365,227
1	Arketimi në Euro	3,512,467	4,196,351	3,972,357
9	Te hyrat tjera operative në Euro	77,928	70,695	36,000
1	Shpenzimet operative	2,934,497	3,154,141	3,417,920
1	Shlyerja e borxheve ndaj kons.	373,256	0	0
1	Shlyerja e obligimeve nga kreditorët	0	0	0
1	Parat e gatshme në bank dhe në arkë	583,425	293,609	1,989,556
1	Stoqet	536,522	604,966	552,375
1	Llogarit e arketueshme Euro	10,926,268	11,025,209	6,111,160
1	Llogarit e pagueshme	8,117,330	11,723,930	7,574,168
1	Numri i punetoreve	260	265	277

1	Numri I ankesave	665	870	600
2	Numri total I testeve të realizuara	2,698	2,816	2,600
2	Matja e treguesve ne %			
2	Uji I pa faturuar	47%	43.5%	43%
2	Përqindja e faturimit	100%	100%	100%
2	Përqindja e konsumit të matur	93%	96%	93%
2	Proporcioni I kons. Me ujmat	98%	99%	99%
2	Efikasiteti I stafit	7.52	7.08	6.58
2	Shkalla e inkasimit në % (të tërë)	87%	97%	91%
2	Shkalla e inkasimit në % - amvisni	88%	92%	83%
2	Shkalla e inkasimit në % - biznese	83%	111%	88%
3	Shkalla e inkasimit në % - industri	83%	107%	100%
3	Norma e mbuleses së punes	1.26	1.35	1.17
3	Norma e punes	1.45	1.40	1.29
3	Shpenzimet Operative per konsumator	6.60	7.03	6.76

Nr i Konsumatorëve janë parashikuar të rriten për duke u nisur nga rritjet e viteve të Kaluara.

Uji i faturuar për konsumatorët me ujëmatës planifikohet të jetë 93 % e ujit total të faturuar.

Faturimi në € - për vitin 2019 planifikohet të jetë 4,365,227 € në vlerë totale. Pjesa më e madhe i faturohet Amvisërisë si kategori më e madhe e konsumatorëve pastaj Biznesi i Madh dhe i Vogël dhe Institucionet. Ne vitin 2020 planifikohet të jetë 4,496,184 €.

Arkëtimi i tërë dhe për kategori të konsumatorëve në Euro ,% , m3 - Prioritet i lartë dhe objektiv i parë strategjik i Kompanisë do të jetë rritja e Shkalles së Arkëtimit. Në vitin 2019 shkalla e Arkëtimit në vlerë totale do të jetë 3,972,357€, 91 % e vlerës së faturuar. Shkalla e Arkëtimit për Amvisëri planifikohet të jetë 83 %, për Biznese Shkalla e Arkëtimit planifikohet të jetë 88%, kurse për institucione 100 %. Ne vitin 2020 Arkëtimi planifikohet të jetë 4,136,489 € , 92 % e vlerës së faturuar , në vitin 2021 4,676,031 €, 93 % e vlerës së faturuar. Nga Fondi i privatizimit të Ndërmarrjeve publike. Shuma e borxhit që i takon Ndërmarrjes tonë është rreth 1,000,000 €, shumë e cila do të na ndihmonte shumë në realizimin e planeve investive. Presione kemi bërë vazhdimisht që këto mjete tona të realizohen pranë AKP-se.

Shpenzimet e përgjithshme operative dhe të mirëmbajtjes në vitin 2019 ,2020 dhe 2021 do të orientohen në funksionimin normal të Kompanisë dhe të gjitha njësive për qëllim të arritjes së

synimeve dhe objektivave të përcaktuara si prioritete. Këto shpenzime si të tilla mundësojnë përmbushjen e obligimeve dhe zhvillimin normal të Kompanisë. Në vitin 2019 shpenzimet operative planifikohen të jenë 3,417,920 €, për 263,779 € më të mëdha se vitit 2018. Ne vitet 2020 Shpenzimet Operative planifikohen të jenë në vlerë të prej 3,520,458 €, në vitin 2021 planifikohen të jenë 3,626,072 €.

Parashikimi i kërkesës për ujë Parashikimet e kërkesave për ujë për vitete planifikuara do të jetë i bazuar në rritje në numrit të konsumatorëve ,në zvogëlimin e humbjeve si dhe në zgjerimin e rrjetave sipas planifikimit afatmesëm për investimet e projekteve kapitale. Parashikimet mujore të prodhimit do të bazohen në prodhimin e vitit 2018.

Investimet kapitale nga Grandet Qeveritare dhe mjetet e KRU-së

Në bazë të projekteve të mëhershme dhe të projekteve aktuale ideore, si të domosdoshme për përmbushjen e nevojave, blerjen e pajisjeve/mekanizmave dhe ndërtimin e objekteve të nevojshme ndërtimore, në vazhdim po i paraqesim projektet domosdoshme të cilat nevojiten për realizimin e planit afatmesëm të investimeve, dhe të cilat njëherit nga pamundësia financiare ne presim që ndonjëra të mund të financohet nga jashtë ose në formë donacioni:

<i>Investimet kapitale për përmirësime infrastrukturore dhe jo infrastrukturore - 2016:</i>		
1.	Investimet jo infrastrukturore	7,277,563
2.	Investimet infrastrukturore	588,143
	TOTALI	7,865,706

Objektivat kryesore

Plani I Biznesit përfshinë synimet afariste të Kompanisë gjatë periudhës 2019-2021 dhe përveç tjerash vlerësohet se do të përmirësoj kontrollin menaxherial mbi Kompaninë dhe shmangien ndaj gabimeve që mund të sjellin atë në dështim të përmbushjes së standardeve të shërbimeve .Plani I Biznesit do ti nënshtrohet rishikimit dhe freskimit në baza vjetore.

KRU"Gjakova" SH.A furnizon me ujë të pijes 37,406 konsumatorë. Synohet që gjer në mbarim të vitit 2021 KRU-ja të zgjeron zonën e shërbimit dhe të rris numrin e konsumatorëve në 42,400.

Gjatë kësaj periudhe KRU"Gjakova" do vazhdoj të furnizoi konsumatorët e vet me ujë 24 orë .

Krahas përmirësimit të shërbimeve të ofruara Kompania synon që gjatë kësaj periudhe të përmirësoi afarizmin ekonomik dhe atë : Duke shtuar përpjekjet në ngritjen e shkallës së arkëtimit në 91 % në vitin 2019 . Të shtoi masat e kontrollit të ujit të prodhuar i cili i'u shpërndahet konsumatorëve dhe me këtë të ndikoi në zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale të ujit ,gjegjësisht të ujit që nuk faturohet dhe Kompanisë nuk i sjellë të ardhura .Uji i pa faturuar në 2019 pritët të ulet në 43 %

Realizimi I këtyre të synimeve do ti mundëson Kompanisë gjenerimin e të ardhurave të mjaftueshme për të qenë vetë financues I qëndrueshëm dhe do ti rrisë aftësitë financiare të Kompanisë për mbulimin e pjesërishëm të investimeve të parapara në periudhën planifikuese.

Kontrolli dhe evitimi I humbjeve teknike dhe komerciale si dhe me mbikqyerjen e shpenzimeve të përgjithshme të Kompanisë ,planifikohet një zvogëlim I shpenzimeve operative .

Krahas ngritjes së kapaciteteve teknike të Kompanisë ,rëndësi e veçante do ti kushtohet ngritjes së aftësive profesionale të stafit ,dhe për këtë menaxhmenti do identifikoi lëmit adekuate për trajnim të stafit .

Për realizimin e qëllimeve kryesore strategjike ,deri në vitin 2021 Kompania ka paraparë përmbushjen e objektivave strategjike si vijon:

- 3 **Zvogëlimi i humbjeve të ujit në rrjetë ;** Këto aktivitete do të përfshijnë identifikimin e humbjeve teknike dhe administrative të sasisë së ujit të prodhuar, gjegjësisht të ujit i cili nuk faturohet dhe nuk i sjell Kompanisë të ardhura. Uji i pa faturuar pritët të ulet në 41% deri në 2021.
- 4 **Zgjerimi i sistemit të rrjetave të reja në vendbanime;** janë pjesë e planit të biznesit e të cilat planifikohen që të realizohen me mjete vetanake të Ndërmarrjes si dhe me mjete nga donacionet nga Qeveria e Kosovës .
- 5 **Ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit –** profil të cilëve kaqe në i pamjaftueshëm për nevojat e konsumatorëve, të cilat janë punarngamaterialejoadekuateosenëatogypajanëdefektetëpërsëritshme;
- 6 **Përmirësimi i funksionimit të sistemit;** Ngritja e nivelit të sigurisë punuese të sistemit të furnizimit me ujë, domosdoshmëria epajisjeve te lemetrike,mjetet e reja pune etj
- 7 **Përmirësimi i matjeve të ujit në sistem dhe te konsumatorët,**
- 8 **Ndrrimi i gypave te Azbest- Cimentos në qytetin e Gjakovës,**
- 9 **Zgjerimi i zones se sherbimit ne fshatra tjera.**

3.7.2 Përmbledhje e arsytimeve për ndryshime te mundshme ne planin e biznesit nga viti paraprak .Çka duhet të jetë më ndryshe se Plani i Biznesit 2018

Ndryshimet e parashikuara nga Plani i Biznesit nga viti paraprak, arsyet për këto ndryshime i prezantojmë për secilin tregues kryesor si më poshtë;

Faturimi në euro-në krahasim me vitin 2018 planifikohet të jetë 4,365,227 €. Gajtë vitit 2018 rritja e faturimit nr m3 dhe euro ka ndodhur dy muajt e fundit te vitit, pasi kemi përfunduar Biznes Planin 2019-2021.Konsiderojmë se do arrihet rritja e këtij treguesi i cili është baza e zvogëlimit të humbjeve të ujit ,eliminimin e lidhjeve ilegale,paushallit si dhe rritjes së numrit të konsumatorëve .Këtë tregues Kompania do ta arrij ta realizoi sipas BP të planifikuar përmes stafit të organizuar të shitjes, grupeve të caktuara sipas 5 zonave , si dhe ndihmesës së institucioneve lokale të Komunave dhe autoriteteve Qendrore .

Uji i faturuar për konsumatorët me ujëmatës planifikohet të jetë 93% e ujit total të faturuar. Kompania përmes angazhimit të stafit të operatives do të arrij qe të bej vendosjen e ujëmatësve për konsumatorët e të gjithë kategorive .Këtë ndryshim të mundshëm nga BP i vitit paraprak kompania e mbështet në arsyetimin se është një ndër objektivat dhe synimet kryesore që të eliminohen faturimi i konsumatorëve përmes paushallit ,sepse është e njohur se me këtë veprim zvogëlohen humbjet e ujit tek Kompania ndërsa te konsumatori bëhet një vlerësim real i shpenzimit të shërbimit të ujit.

Arkëtimi i tërë në Euro, % dhe m3 – Bazuar në BP që në vitin 2019 Arkëtimi në vlerë totale do te jete 3,972,357 € , 91 % e vlerës së faturuar. Bazohet në arsyetimin se Kompania si Ndërmarrje vetë financuese ku të ardhurat i siguron vetëm nga arkëtimi do të gjej metodat ,programet më të avancuara që maksimalisht të arrij shkallen më të lartë të mundshme të inkasimit përmes : Organizimit të Grupeve të Kontrolles dhe Çkyçjes ,përcaktimin e grupeve sipas 5 zonave , rritjen e numrit të pikave të shitjes në tërë regjionin që operon Kompania , zonave për arkëtim dhe humbje të ujit, eliminimit të keqpërdorimit të ujit , riprogramimet e borxheve me te gjitha kategoritë e konsumatorëve ,eliminimit të humbjeve teknike ,bashkëpunimit me palët e treta ,Policinë ,Inspektorët Komunal si dhe autoritet gjyqësore.

Shpenzimet Operative – Shpenzimet operative për vitin 2019 sipas BP do të jenë 3,417,920 euro për 359,554 € më të larta se planifikimi i vitit 2018. Shkaku i këtij ndryshimi në planifikimin e BP është se Kompania po përballlet me dukurit ; bashkëfinancimi nga buxheti i Kompanisë ne realizimin e Projekteve të mëdha,ndërtimi me mjete vetanake të infrastruktures ujore , infrastrukturës rrugore , ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës së objekteve të kompanisë, Rritjen e inflacionit, rritjes së vazhdueshme të çmimit të energjisë elektrike, kemikaleve, karburanteve te naftës, mirëmbajtja e pajisjeve dhe rrjetës. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përfshijnë shpenzimet e personelit (përfshin pagat, mëditjet, bonuset, trajnimet), shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimeve (përfshin pjesët e vogla për riparim, mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, mirëmbajtja e automjeteve etj), shpenzimet e energjisë elektrike, shpenzimet e derivateve (përfshin naftën dhe benzinës për Kompaninë), shpenzimet e kemikaleve (përfshin alumin sulfatin, klor i gazet, klor i lënget, kloruri i hekurit dhe karboni aktiv), si dhe shpenzimet tjera (përfshin shpenzimet administrative, regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve,taksat për licencim të shërbimeve ARRU, taksa e SHUKOS-it, taksa për shfrytëzimin e ujit MMPH, shërbimet nga palët e treta). Gjatëvitit2017Kompaniaparashehtipaguajëtëgjithashpenzimetoperativepërzhvillimineveprimtarisë normale.

Nr i Konsumatorëve- për vitin 2019 janë parashikuar të rriten 4,700 konsumatorë duke u bazuar nga rritjet e viteve të Kaluara. Kompania do të bëjë evidentimin në sistem të konsumatorëve të cilët furnizohen në mënyrë të pa legalizuar ,do ekzekutoj dënime administrative si dhe gjoba për konsumatorët e pa ndërgjegjshëm që keqpërdorin ujin

.Ndërtimi i Fabrikës së dytë të ujit të pijes do të mundësohet që të rritet numri i konsumatorëve në masë të madhe sepse Kompania do të ketë kapacitet të mjaftueshëm për zgjerimin e shërbimeve të veta .

Prodhimi i ujit të pijes - Prodhimi i ujit për vitin 2019 është planifikuar të jetë 15,758,606 m3, për 263,704 m3 më shumë se BP i vitit 2018 si nevojë dhe mundësi e rritjes së numrit të konsumatorëve për shkak të rritjeve të kapacitetit të ujit për shkak të ndërtimit të Fabrikës së dytë me kapacitet shtesë 500 m3.

Programet e testimit të ujit të pijshëm- Përmirësimi i cilësisë së ujtitë pijshëm,në laboratorët tona,si në atë për analizatfiziko- kimike dhe atë bakteriologjike, të përdorim disa programe të testimit të cilësisë së ujit,si p.sh.:Programi i analizës volumetrike pH-metrisë, konduktometrisë, fotometrisë etj.

Ristrukturimi organizativ – Radhitja e personelit për mes departamenteve në favor të produktivitetit të përgjithshëm, duke ngritur ato në vazhdimësi për mes përgatitjes dhe të përshtatjes profesionale;Pozicionimin dhe vërtetimin e pozitave të pasistematizuara deri më tani dhe,sipas nevojës për pozitë e punëve të domosdoshme;Të bëhet planifikimi i mundësisë së kualifikimit të vazhdueshëm të personelit përmes shkollimit.

